



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 44 regjistër (JR)
Datë 09.08.2021

Nr. 44 i vendimit
Datë 25.10.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 25.10.2023, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Tomorr Kullolli, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 396, datë 09.06.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Tomorr Kullolli.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe parashtrimet me shkrim, i cili përfundimisht kërkoi konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Tomorr Kullolli (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me nr. {***} prot., datë 27.09.2018, duke konstatuar se:
 1. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin.*
 2. *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 3. *Ka kryer fshehje pasurie.*
 4. *Ka kryer deklaram të rremë.*
 5. *Subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
4. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë. Bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit, si dhe pasi shqyrtoi të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin që për

subjektin e rivlerësimit Tomorr Kullolli, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 396, datë 09.06.2021, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit nga detyra, është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për kriterin e pasurisë.

5.1. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë: *Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Për rrjedhojë, subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklaramit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Mbi ankimin dhe shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit

6. Më datë 21.07.2021, është depozituar nga subjekti i rivlerësimit, ankimi i protokolluar në Komision me nr. {***} prot., kundër vendimit nr. 396, datë 09.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63¹, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në konkluzion të ankimit të tij, subjekti i rivlerësimit kërkoi që shkaqet e ankimit t'i marrë në shqyrtim Kolegji, duke kërkuar:
- (i) *Vendimi është i pabazuar në prova e në ligj e, si i tillë, duhet të priset.*
 - (ii) *Duke qenë se vendimi është pasojë e cenimit të procesit të rregullt ligjor dhe shkeljes së një serie të drejtash, çështja duhet të kthehet për rishqyrtim në organin më të ulët të rivlerësimit. Kjo për shkakun se nëse do të mbahej për shqyrtim pranë Kolegjit, do cenohej e drejta e ankimit në një shkallë më të lartë gjykimi, pasi pas vendimit të Kolegjit, gjykimi për rivlerësimin përfundon.*
 - (iii) *Nëse çështja nuk vlerësohet se duhet të kthehet për rishqyrtim, gjykimi të zhvillohet në seancë gjyqësore publike, në mënyrë që të garantohet e drejta e mbrojtjes, e shkelur në procedimin administrativ.*
 - (iv) *Të ribëhet nga Kolegji hetimi për kriterin e pasurisë dhe të hetohen edhe dy kriteret e tjera.*

- 6.1.** Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

6.1.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se meqenëse ka paraqitur kërkesë në Këshillin e Lartë Gjyqësor për mbarimin e statusit të magjistratit dhe trajtimin me pension të parakohshëm, Komisioni duhej të priste vendimmarrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi janë të ndërvarur nga njëri-tjetri. Komisioni, pa pritur vendimmarrjen e KLGj-së, ka kaluar çështjen në seancë dëgjimore

¹ “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit”.

në datën 02.06.2020. Edhe në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pezullimin e procesit të tij të rivlerësimit deri në vendimmarrjen e KLGj-së, pasi nëse statusi i magjistratit mbaronte, procesi i rivlerësimit nuk mund të vazhdonte.

6.1.2. Subjekti i rivlerësimit, në ankim pretendoi se i është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor nga një vendim i paarsyetuar. Subjekti pretendon se nga mungesa e arsytimit të vendimit në disa elemente, i është shkelur e drejta e ankimit, si një aspekt i së drejtës për një gjykim të drejtë.

Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë

6.1.3. *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 67,4 m²*, ndodhur në lagjen "{***}", Elbasan, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka arritur në konkluzion të padrejtë, pasi ka pasur gjendje të likuiditeteve *cash* në banesë të paktën që nga viti 2000, një shumë jo më të vogël se 1.721.384 lekë, që përbën të ardhurën nga dividendi i fituar në shoqërinë "{***}" ShA, Elbasan, e cila është përdorur tërësisht për blerjen e apartamentit në vitin 2004.

Sa i përket moskonsiderimit si e ardhur e ligjshme të dividendit të përfituar në vitin 2000, si pasojë e mosprovimit të faktit të pagimit të tatimit mbi të ardhurat për shumën e fituar si dividend, sipas subjektit të rivlerësimit është një përfundim që vjen në kundërshtim me ligjin. Tatimi mbi të ardhurat paguhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998.

Subjekti pretendon se si burim për blerjen e aksioneve, kanë shërbyer letrat me vlerë të përfituara nga paraardhësit e tij, si të dënuar politikë të regjimit komunist.

6.1.4 *Lidhur me pasurinë shtëpi private dykatëshe*, ndodhur në rrugën "{***}", lagjja "{***}", Elbasan, subjekti i rivlerësimit pretendon se në lidhje me blerjen e kësaj banese, kanë shërbyer si burim disa kontrata huaje, të marra në vitin 2006, deklaruar në DIPP-në e këtij viti. Subjekti sqaron se ka marrë hua gjithsej në masën 6.000.000 lekë, nga shtetasit A. A., S. M., P. Xh., A. Xh. dhe nga A. K., dhe se nuk është i drejtë konkluzioni i Komisionit se nuk është provuar burimi i ligjshëm i huave të dhëna prej tyre, pasi nga provat e paraqitura, provohet fakti se huadhënësit kanë pasur mundësi financiare për t'i dhënë hua shumat respektive. Për këto shkaqe, sipas tij, nuk ka pasaktësi në deklarimin e huasë për S. M. n në vitin 2006 dhe subjekti ka pasur mundësi të blejë banesën në këtë vit.

6.1.5 *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 134 m²*, ndodhur në Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka shpjeguar bindshëm të ardhurat për blerjen e kësaj pasurie. Sipas subjektit të rivlerësimit, pushimi i procedimit penal nga prokuroria dhe gjykata, provon ligjshmërinë e të ardhurave të babait dhe për këtë shkak, edhe shuma e përfituar si dhurim, është nga të ardhura të ligjshme. Pjesa tjetër ka qenë me të ardhurat nga shitja e tokës në vitin 2013. Me këto të ardhura mbulohet tërësisht blerja e banesës në vitin 2014. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat janë përfituar përpara kthimit të tokës me vendim të AKP-së, por posedimin e tokave, babai i tij e ka marrë që në fillim të viteve '90, pasi zotëronte aktin e vjetër të pronësisë.

6.1.6 Lidhur me rezultatet e analizës financiare, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij, të parashtruara në seancë dëgjimore, duke pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Subjekti pretendon se ka paraqitur deklarata noteriale që provojnë marrëdhënien e huasë që ka shërbyer si burim për blerjen e shtëpisë dykatëshe, ndaj provohet tërësisht marrja e tyre në vitin 2006 dhe kthimi i tyre siç i ka deklaruar në DIPP-të përkatëse. Subjekti pretendon se të ardhurat nga pagat, nga aksionet dhe qirasë në shumën 600.000 lekë çdo vit, kanë mjaftuar për të mundur kthimin e huave. Lidhur me të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e apartamentit me sipërfaqe 67,4 m², i cili është përshtatur për objekt tregtie dhe është dhënë me qira, pretendon se i ka deklaruar në deklaratat e periodike të pasurisë për të provuar marrëdhënien e qirasë. Lidhur me shpenzimet e shkollimit të djalit, subjekti pretendon se të dhënat e akteve të dorëzuara prej tij dhe ato të përdorura si prova nga Komisioni, janë akte me të njëjtin burim e, për këtë shkak, kanë të njëjtën fuqi provuese.

IV. Vlerësimi i trupit gjyqësor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit Tomorr Kullolli, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

8. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 1² e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për

² “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

rrjedhje, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 396, datë 09.06.2021, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Tomorr Kullolli, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

9.1. Trupi gjykues shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur në ankim, nëpërmjet së cilës subjekti kërkoi nga Kolegji që gjykimi i çështjes së tij të zhvillohet në seancë gjyqësore publike.

9.2. Subjekti i rivlerësimit, në faqen e fundit të ankimit, ka kërkuar nga Kolegji të merren dhe të vlerësohen si prova aktet e mëposhtme.

(i) Vendimi i KLGj-së, datë 02.06.2020.

(ii) Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të KLGj-së në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Këto dy dokumente nuk gjenden në dosjen e Komisionit bashkëngjitur ankimit.

Subjekti i rivlerësimit, më datë 20.10.2023, në funksion të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi që do të zhvillohej në Kolegj më datë 25.10.2023, paraqiti parashtrime me shkrim, protokolluar me nr. {***}, të cilave u ka bashkëngjitur edhe disa akte³, që kërkoi të merren si prova të reja nga Kolegji.

9.3. Lidhur me provat që citohen në ankim, gjyqtarja relatores e çështjes, bazuar në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.06.2023, i dërgoi Komisionit kërkesë për dokumentacion, nëpërmjet së cilës i kërkohet përcjellja e informacionit nëse subjekti i rivlerësimit i ka paraqitur këto akte gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, dhe nëse po, të përcillen pranë Kolegjit. Në përgjigje⁴ të kësaj shkrese, Komisioni ka sqaruar se këto akte nuk janë administruar gjatë procedurës së hetimit administrativ në Komision dhe nuk kanë shërbyer e as nuk referohen në vendimin përfundimtar nr. 396, datë 09.06.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit. Si rrjedhojë, këto akte, në kushtet e mungesës së tyre në fashikull, si dhe bashkëlidhur ankimit, nuk iu nënshtruan vlerësimit në Kolegj për administrimin ose jo në cilësinë e provës, në funksion të zhvillimit të gjykimit të çështjes së subjektit të rivlerësimit.

9.4 Lidhur me aktet që subjekti i rivlerësimit u ka bashkëngjitur parashtrimeve të dorëzuara në Kolegj më datë 20.10.2023, trupi gjykues sjell në vëmendje parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë. Referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”), i ndryshuar, parashikohet se: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja*

³ - Kërkesë e subjektit të rivlerësimit, drejtuar Komisionit, datë 16.10.2023.

- Kthim përgjigje e Komisionit, drejtuar subjektit të rivlerësimit, me nr. {***} prot., datë 11.10.2023.

- Printim ekrani (print screen) i adresës elektronike zyrtare joaktive të subjektit të rivlerësimit.

- Dokument nga zyra e financës së Universitetit {***}.

- Mandatpagese nga Alpha Bank, datë 18.10.2000.

- Vërtetim, datë 18.10.2023, i lëshuar nga shoqëria “{***}” ShA.

- Vërtetim, datë 17.10.2023, lëshuar nga shoqëria “{***}” ShA.

- Printim nga faqja e Gjykatës së Lartë për statusin e çështjes nr. {***}.

- CD me dokumentacionin e hetimit administrativ në Komision.

⁴ Me shkresën nr. {***} prot., datë 07.07.2023.

dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj. Gjithashtu, sipas nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.* Trupi gjykues, pasi vlerësoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të lejuar marrjen e akteve si prova të reja, si dhe verifikoi kërkesën e tij për gjykimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike, vendosi që aktet bashkëngjitur parashtrimeve, të mos merren në cilësinë e provës, pasi nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në nenet 47 dhe 49, paragrafi i dytë i ligjit 49/2012, i ndryshuar, duke arsyetuar si vijon.

9.5 Në zbatim të parashikimeve ligjore, Kolegji vlerësoi se për aktet e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, bashkëlidhur parashtrimeve, nuk provohet se pamundësia e paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ në Komision, nuk ka qenë pa fajin e tij, siç parashikon neni 47 i ligjit nr. 49/2012. Në vlerësim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj, me praninë e subjektit të rivlerësimit, për korrigjimin e tyre. Në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, gjykimi në Kolegj, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezultoi i nevojshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike për t'i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar edhe në Kolegj. Gjithashtu kërkimi⁵ që paraqet subjekti i rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, nuk parashikohet në rastet specifike ligjore të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Kolegji vlerësoi kryesisht se: (a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; (b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; si dhe (c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

9.6 Kolegji, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, vlerësoi si të pabazuar në ligj kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ndaj vendosi të vijojë ta shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit

Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit

10. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se meqenëse ka paraqitur kërkesë në Këshillin e Lartë Gjyqësor për mbarimin e statusit të magjistratit dhe trajtimin me pension të parakohshëm,

⁵ Referuar paragrafit 6, pika (iii) e këtij vendimi.

procese të cilat ndërvaren nga njëri-tjetri, Komisioni duhej të priste vendimmarrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Komisioni, pa pritur vendimmarrjen e KLGj-së, ka kaluar çështjen në seancë dëgjimore në datën 02.06.2020. Edhe në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pezullimin e procesit të tij të rivlerësimit deri në vendimmarrjen e KLGj-së, pasi nëse statusi i magjistratit mbaronte, procesi i rivlerësimit nuk mund të vazhdonte. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji që të ndërpritet përfundimi i procesit për shkak të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pension të parakohshëm, e cila, në momentin e dorëzimit të ankimit objekt shqyrtimi, ishte ankuar nga subjekti në Gjykatën e Apelit Administrativ. Subjekti ka pretenduar se nëse çështja nuk vlerësohet se duhet të kthehet për rishqyrtim, gjykimi të zhvillohet në seancë publike, në mënyrë që të garantohet e drejta e mbrojtjes, e shkelur në procedimin administrativ.

10.1 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se gjatë hetimit administrativ, pas njoftimit të rregullt në rrugë elektronike nga Komisioni, drejtuar subjektit për t'u njohur me dosjen, subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit për njohjen me dokumentacionin që i përkiste çështjes së tij të rivlerësimit dhe as paraqiti shpjegimet dhe parashtrimet e tij brenda afatit që i ishte caktuar nga Komisioni. Në datën 02.03.2021, subjekti ka paraqitur në KLGj një kërkesë të përvokueshme për heqje dorë nga statusi i magjistratit, të cilën e ka depozituar të njëjtën ditë edhe pranë Komisionit. Në këto kushte, Komisioni, më datë 05.03.2021, ka vendosur që të kryejë verifikime të mëtejshme lidhur me vendimmarrjen e KLGj-së, duke mos e caktuar datën për seancë dëgjimore për këtë subjekt menjëherë pas mbarimit të afatit për paraqitjen e prapësimeve të tij. Më pas, ka rezultuar se në datën 23.03.2021, subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë nga kërkesa e mësipërme, ndonëse ajo ishte e përvokueshme dhe pa ia bërë me dije Komisionit këtë veprim të tij. Komisionit i është përcjellë nga KLGj-ja, vendimi nr. {***}, datë 08.04.2021, me të cilin ishte përfunduar procedura e shqyrtimit të kërkesës së subjektit për mbarimin e statusit të magjistratit, pikërisht për shkak të heqjes dorë prej tij nga kjo kërkesë.

10.2 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi prapësime në Komision, pasi më datë 23.03.2021, i kishte bërë kërkesë KLGj-së për miratimin e pensionit të parakohshëm. Në vijim, Komisioni, nëpërmjet *e-mail*-it të datës 19.05.2021, i ka bërë me dije subjektit se fakti i paraqitjes së kësaj kërkesë në KLGj, nuk kishte asnjë efekt pezullues për procesin e tij të rivlerësimit në Komision, duke e ftuar sërish që të paraqiste qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit deri në datën e përcaktuar, 20.05.2021, nëse do ta vlerësonte të dobishme për mbrojtjen e tij, pasi kishte kaluar shumë kohë nga data 25.02.2021, kur janë njoftuar rezultatet e hetimit administrativ. Meqë subjekti nuk paraqiti shpjegime mbi rezultatet e hetimit, si dhe në kushtet ku kishte kërkuar që të pezullohej procesi i tij i rivlerësimit derisa të shprehej KLGj-ja për kërkesën e tij për pension të parakohshëm, Komisioni vijoi me caktimin e datës së seancës dëgjimore më datë 02.06.2021, pasi kjo kërkesë nuk përbënte shkak për pezullimin e procedurës së rivlerësimit.

10.3 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, me gjithë njoftimet e Komisionit, nuk dërgoi parashtrimet mbi rezultatet e hetimit, pasi ishte në pritje të vendimit të KLGj-së. Komisioni i ka bërë me dije subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike, datë 19.05.2021, se procesi i rivlerësimit është i pavarur dhe nuk ndërpritet për shkak të kërkesave që mund të ketë paraqitur subjekti, lidhur me rrethana që nuk ndikojnë në veprimtarinë e Komisionit për rivlerësimin e

subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me këtë qëndrim të Komisionit për vazhdimin e procesit të rivlerësimit për subjektin Tomorr Kullolli, përpos sa ka konstatuar Komisioni, vlerësoi se ky proces është i një natyre të posaçme, i cili nuk mbivendoset dhe as konkurren me procese të tjera. Përveç sa më sipër, duke konsideruar edhe faktin që pezullimi i hetimit administrativ deri në vendimmarrjen e KLGj-së, mund të krijojë kushte të cilat subjektet mund t'i përdorin për zvarritjen e procesit të tyre të rivlerësimit, konsideroi të drejtë qëndrimin e Komisionit për të vijuar procesin e rivlerësimit për subjektin Tomorr Kullolli, për sa kohë nuk ka pasur njoftim nga KLGj-ja për mbarimin e statusit të magjistratit. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit nuk ishte në kushtet që kishte mbushur moshën për pension të plotë pleqërie (67 vjeç), si një e drejtë, zbatimi i së cilës buron drejtpërdrejt⁶ nga ligji, por të një të drejte e cila ushtrohet bazuar në kërkesën/vullnetin e magjistratit për të mos vijuar më tej detyrën dhe për të përfituar pensionin e parakohshëm

Nga sa më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit zgjodhi të mos njihet me dokumentacionin që i përket çështjes së tij të rivlerësimit, pasi me gjithë thirrjet e Komisionit për t'u njohur me dosjen dhe depozitimin e prapësimeve të rezultateve të hetimit, vazhdoi të kërkonte pezullimin e çështjes në Komision. Në përfundim, trupi gjykues nuk e gjen të drejtë dhe të bazuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për t'i garantuar të drejtën e mbrojtjes, pasi konstatoi se kjo e drejtë i është ofruar në mënyrë të përsëritur gjatë procesit administrativ në Komision, dhe subjekti refuzoi ta ushtronte, në këto kushte nga Kolegji vlerësohet i drejtë qëndrimi i Komisionit për të mos pezulluar procesin e rivlerësimit që i përket subjektit Tomorr Kullolli.

11. Subjekti i rivlerësimit, në përfundim të ankimit, pretendon se i është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor nga një vendim i paarsyetuar. Subjekti pretendon se nga mungesa e arsytimit të vendimit në disa elemente, i është shkelur e drejta e ankimit, si një aspekt i së drejtës për një gjykim të drejtë. Subjekti në këtë kërkim ka pretenduar shkeljen e këtyre parimeve në mënyrë të përgjithshme, pa evidentuar rrethana konkrete, si dhe pasoja që i kanë ardhur subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të tij të rivlerësimit në Komision, ose lidhur me arsytimin në vendimin e Komisionit, duke vështirësuar ushtrimin e kontrollit nga Kolegji ndaj shkeljeve të pretenduara.

11.1 Kolegji, edhe në mungesë të sqarimeve të subjektit të rivlerësimit se përse është i paarsyetuar vendimi i Komisionit, shqyrtoi pretendimin e tij, duke sjellë në vëmendje jurisprudencën⁷ e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e cila thekson domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Ajo arsyeton se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve, në përfundim të gjyqimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimet përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë

⁶ Në këtë rast, disponimi për procesin e rivlerësimit të subjektit do të ishte i ndryshëm dhe mund të bënte kuptim pezullimi deri në marrjen e vendimit nga KLGj-ja për deklarim të mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të daljes në pension të plotë pleqërie.

⁷ Shih vendimet nr. 3, datë 26.01.2015, nr. 63, datë 23.09.2015, nr. 24, datë 25.04.2016, nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Gjykata verifikon nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërcituara. Në referencë të sa më sipër, lidhur me domosdoshmërinë e arsytimit të vendimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi është arsyetuar në përputhje me standardet e kërkuara nga Gjykata Kushtetuese dhe, si rrjedhojë, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi është i paarsyetuar, për pasojë nuk evidentoi shkelje të procesit të rregullt ligjor.

Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

12. ***Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 67,4 m²***, në lagjen "{***}", Elbasan, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka arritur në konkluzion të padrejtë, pasi ka pasur gjendje të likuiditeteve *cash* në banesë të paktën që nga viti 2000, një shumë jo më të vogël se 1.721.384 lekë, që është e ardhur nga dividendi i fituar në shoqërinë "{***}" ShA Elbasan, të cilën pretendon se e ka provuar. Subjekti argumenton se në deklarin periodik e ka deklaruar këtë burim të ardhurash dhe mosdeklarimi i gjendjes *cash* në banesë ka ardhur si pasojë e një paqartësie për mënyrën e deklarin të pasurisë. Sipas subjektit, shuma e tërhequr si dividend është përdorur tërësisht për blerjen e apartamentit në vitin 2004, ndaj kjo shumë dhe të ardhurat nga paga në vitin 2004, mbulojnë tërësisht diferencën negative të këtij viti të konkluduar nga Komisioni. Subjekti pretendon se korrigjimi i pasaktësive në vitin 2007, tregon për një vullnet të pavesuar, pasi në atë periudhë nuk ishte iniciuar ideja për procesin e *vetting*-ut.
- (i) Sa i përket moskonsiderimit si e ardhur e ligjshme të dividendit, si pasojë e mosprovimit të faktit të pagimit të tatimit mbi të ardhurat për shumën e fituar si dividend, sipas subjektit të rivlerësimit është një përfundim që vjen në kundërshtim me ligjin. Tatimi mbi të ardhurat paguhet në përputhje me kërkesat e ligjit të kohës nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", aktualisht i shfuqizuar. Sipas këtij ligji, si subjekte të tatimit mbi të ardhurat janë edhe përfituesit e dividendëve nga zotërimi i aksioneve në shoqëritë tregtare. Në bazë të nenit 33 të këtij ligji, në rastin e dividendit, tatimi paguhet nga shoqëria në formën e detyrimit si tatim në burim. Për këtë arsye, subjekti, si përfitues i dividendit, nuk kishte detyrimin për të paguar tatime.
- (ii) Subjekti pretendon se si burim për blerjen e aksioneve, kanë shërbyer letrat me vlerë të përfituara nga paraardhësit e tij si të dënuar politikë të regjimit komunist. Lidhur me pronësinë e aksioneve në këto shoqëri, sqaron se i ka blerë në vitin 1995 me ankand të mbyllur nga shteti shqiptar. Banka e Kursimeve, nëpërmjet së cilës babai i subjektit i ka kaluar këtij të fundit letrat me vlerë që t'i përdorte për ankandin e privatizimit, pas interesimit të subjektit, rezulton se nuk disponon dokumentacion, pasi ato ruhen deri në 10 vjet. Në konkluzion të këtij shkaku ankimi, subjekti pretendon se provohet ligjshmëria e burimit të të ardhurave për blerjen e aksioneve dhe pagimi i tatimit mbi të ardhurat për dividendin. Për pasojë, në vitin 2004 subjekti pretendon se ka pasur mjaftueshëm të ardhura për blerjen e banesës. Diferenca negative e vlerësuar nga Komisioni,

është pasojë e mosmarrjes në konsideratë të provave të paraqitura dhe e zbatimit të gabuar të ligjit tatimor.

12.1 Komisioni për kriterin e pasurisë ka arritur në konkluzionet si vijon: *Lidhur me ligjshmërinë e shumave të përdorura në vitin 2004, trupi gjykues vlerëson të vërë në pah faktin që, edhe nëse do të konsiderohej i mirëqenë burimi i ligjshëm i blerjes së aksioneve në fjalë, sërish do të gjendeshim përballë mungesës së provës mbi zotërimin faktik dhe mbi ligjshmërinë e burimeve financiare të përfituara nga dividendët e shoqërive aksionare të lartpërmendura, pasi nuk është deklaruar kursimi në gjendje cash dhe as nuk është provuar pagesa e tatimit mbi shumat e përfituara nga dividendët. Pretendimi i subjektit se këto tatime janë paguar nga vetë shoqëritë që kanë gjeneruar dividend, nuk rezulton të jetë i provuar. Për rrjedhojë, edhe në rast se do të pranohej pretendimi i subjektit mbi disponimin e këtyre kursimeve nga viti 2000 deri në vitin 2004, duke e konsideruar mosdeklarimin e gjendjes cash vetëm si një pasaktësi – çka do të binte ndesh me dispozitat ligjore dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit – këto të ardhura gjithsesi nuk mund të konsideroheshin me burim krijimi të ligjshëm, për sa kohë nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore mbi këto shuma të përfituara nga subjekti nëpërmjet aksioneve të tij. Nisur nga sa më lart, konfirmohet mungesa financiare për vitin 2004, në vlerën negative prej 1.572.552 lekësh.*

Së fundmi, lidhur me këto burime të ardhurash, evidentohet se arsyetimi i mësipërm – mbi pengesën/mungesën e trefishtë, të kushteve të paplotësuara, për konsiderimin e tyre si burime të ligjshme – vlen dhe duhet të mbahet në konsideratë edhe përgjatë analizave financiare të viteve të mëpasme, për aq kohë sa rigjendemi në rrethana të ngjashme, pra, përballë shpenzimeve të subjektit, të kryera me të ardhura nga dividendët, për të cilat, edhe kur janë deklaruar si të ardhura në vitet përkatëse, nuk rezultojnë të jenë shlyer detyrimet tatimore.

Lidhur me pretendimin e subjektit për të ardhurat e realizuara nga shitja e një pjese të aksioneve të shoqërive të sipërcituara, trupi gjykues çmon se duhet konsideruar në analizën financiare vetëm pjesa e çmimit të përfutur ekuivalent me çmimin e blerjes, duke mos e konsideruar si një burim të ligjshëm diferencën midis dy çmimeve, për sa kohë nuk është provuar pagesa e blerjes së këtyre aksioneve me burime të ligjshme financiare [...].

12.2 Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament 67,4 m², ndodhur në lagjen {***}, zona kadastrale nr. {***}, bashkia Elbasan, nga të ardhurat familjare.*

*Aksione të shoqëria {***} ShA Elbasan, nga viti 1996-2014, zotëruar 7872 aksione dhe pas vitit 2014, zotëruar 3936 aksione. Aksione të shoqërisë ShA {***} nga viti 1996-2014, zotëruar 2057 aksione dhe pas vitit 2014, 1028,5 aksione.*

Në Deklaratën e Interesave Privatë Periodikë (në vijim “DIPP”) të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament blerë nga bashkëshortja, lagjja {***}, 1.900.000 lekë, me të ardhurat e marra si dividend në shoqërinë {***} ShA, në shumën 1.721.348 lekë, pjesa takuese 100%, mandatpagesa datë 18.10.2000, deklaruar në vitin 2001, si dhe të ardhura të tjera pas vitit 2000 (plotësimi i deklaratës është kryer me shkrim dore). Në këtë deklaratë, burimi i krijimit të pasurisë është plotësuar nga subjekti i rivlerësimit si shtesë/korrigjim i këtij deklarimi në vitin 2007 dhe është nënshkruar prej tij në faqen nr. 3 të kësaj deklarate, duke vënë edhe datën 11.01.2007.

Subjekti ka shpjeguar në prapësimet e rezultateve të hetimit, të dorëzuara në seancën dëgjimore në Komision, se e ka kryer këtë korrigjim duke qenë se nuk ka deklaruar burim për krijimin e pasurisë, pasi sipas tij nuk janë kryer trajnime nga ana e ILDKPKI-së në lidhje me plotësimin e deklaratave të pasurisë.

12.3 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se me kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 24.09.2004, shitësit A. dhe A. S. i kanë shitur bashkëshortes së subjektit, znj. L. K., pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 67,4 m², me nr. pasurie {***}, në lagjen “{***}”, Elbasan, me çmimin 1.950.000 lekë, referuar në kontratën e shitjes si të likuiduar paraprakisht jashtë zyrës noteriale.

Në lidhje me analizimin e burimeve të krijimit të blerjes së kësaj pasurie, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në plotësimin që ka bërë në datën 11.01.2007 në DIPP-në e vitit 2004, ka përfshirë të ardhurat e përfituara nga dividendi, në shumën 1.721.348 lekë, dhe gjithashtu pretendon kursime të tjera pas vitit 2000. Në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje të likuiditeteve *cash*, kursime apo në ndonjë formë tjetër.

Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit lidhur me deklarin se burimet e përdorura për këtë apartament kanë qenë nga dividendët e shpërndarë nga shoqëria “{***}” ShA, më 18.10.2000, të ardhura të tjera pas vitit 2000, si dhe mosdeklarimin e ndonjë gjendjeje të disponuar *cash* në banesë në vitin 2003, për të cilat subjekti ka shpjeguar se: *Nuk më kujtohet, po fakti që këto të ardhura janë siguruar nga shpërndarja e dividendëve, është e vërtetë, pasi janë pasqyruar mandatkanimet e bankës, të cilat i kam deklaruar si në vetting ashtu dhe në ato periodike, duke mos dhënë asnjë shpjegim mbi mosdeklarimin e gjendjes cash. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion mandatet e pagesave të cituara prej tij dhe nuk ka dhënë ndonjë shpjegim për mosdeklarimin e gjendjes cash të pretenduar prej tij si të disponuar në banesë.*

12.4 Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për këtë pasuri, me rezultatet e hetimit administrativ duke konstatuar se:

- Duket se ka mospërputhje midis të ardhurave nga qiraja: (i) të deklaruara ndër vite, krahasuar me të ardhurat në total; (ii) të deklaruara në deklaratën *vetting*; dhe (iii) atyre të provuara nëpërmjet kontratave të qirave.

- Duket se për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në masën 1.572.552 lekë.

12.5 Lidhur me barrën e provës së kaluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime, duke pretenduar që procesi i tij i rivlerësimit duhet të pezullohet për shkak të kërkesës së tij drejtuar KLGj-së për dalje të parakohshme në pension. Komisioni, pasi i ka kthyer përgjigje⁸ që kjo kërkesë nuk ndikon në procesin e rivlerësimit, ka caktuar datën e seancës gjyqësore më 02.06.2021, ku e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të mbajë qëndrim lidhur me rezultatet e hetimit. Pikërisht në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kundërshtimet mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës së kaluar nga Komisioni. Subjekti ka sqaruar se po të merren parasysh të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës para vitit 2004, provohet plotësisht mundësia për kursime në

⁸ Paragrafi 7.2 më sipër.

një masë më të lartë se 1.572.552 lekë. Subjekti ka argumentuar në kundërshtimet mbi rezultatet e hetimit, se të ardhurat e tij familjare nga paga dhe të ardhura të tjera deri në vitin 2003, si dividendi i vitit 2003, kanë qenë ndjeshëm më të larta se shpenzimet dhe ai ka pasur mundësi që, përveç jetesës, të sigurojë edhe kursime.

12.6 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë pasur gjendje *cash* në banesë në vitin 2004, që buron nga dividendi i ndarë në vitin 2000 nga shoqëria “{***}” ShA, të cilin nuk e ka deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike apo në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003. Në kontekst të sa më sipër, si dhe duke analizuar deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike, rezulton se, bazuar në dispozitën e kohës – neni 4, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” – subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve, për të mundësuar në këtë mënyrë kontrollin e pasurisë së tij nëpërmjet procesit të rivlerësimit. Në sqarimet e subjektit të rivlerësimit, dhënë në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, si dhe në ankim, sipas të cilave ka sqaruar se ka qenë mungesa e trajnimit nga ana e ILDKPKI-së në lidhje me plotësimin e deklaratave të pasurisë, është një situatë faktike, e cila pamundëson kontrollin e rrjedhjes së gjendjes së *cash*-it ndër vite, duke devijuar edhe analizën financiare me alternativa të ndryshme. Ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarinimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre dhe jo të zgjedhë mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor. Forma e deklarinimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar i cili duhet respektuar.

12.7 Kolegji vëren se mungesës së deklarinimit të gjendjes *cash* nga subjekti i rivlerësimit, i shtohet edhe mosprovueshmëria për vërtetësinë e shpërndarjes së dividendit në vitin 2000 nga shoqëria “{***}” ShA, në shumën 1.721.384 lekë, për të cilën subjekti i rivlerësimit për ta mbështetur si pretendim, dorëzoi vetëm një vërtetim nga kjo shoqëri, lëshuar në vitin 2017 (për ILDKPKI-në) për efekt të procesit të rivlerësimit, duke mos pasur në dispozicion dokumente të tjera si mandate bankare, dokumente nga shoqëria për dhënien e kësaj shume në kohë reale, për të provuar që subjekti ka përfituar dividendin në vitin 2000. Subjekti i rivlerësimit ka bërë një korrigjim të deklaratës së vitit 2004, duke vënë shënimin dhe datën e këtij plotësimi më 11.01.2007, cituar në paragrafin 12.2 më sipër, korrigjim i cili është kryer tri vite pas plotësimit të kësaj deklarate. Duke iu referuar nenit 24 të ligjit nr. 9049/2003, paragrafi i dytë i këtij neni parashikon: *Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale, mospërputhje midis deklaratës së dorëzuar personalisht në formë fizike dhe deklaratës së dorëzuar me mjete të komunikimit elektronik, ose plotësime të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t’i ndreqë ato.* Nga kjo dispozitë rezulton se në rast të gabimeve materiale, mospërputhjeve, si dhe plotësimeve të gabuara, mund të ndreqen brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit prej këtij institucioni, plotësime të cilat duhet të rregullohen, pasi ILDKPKI-ja ka konstatuar një nga rastet e parashikuara në këtë dispozitë për

ndërhyrje dhe ndreqje, por në asnjë rast nuk evidentohet plotësimi i burimeve të krijimit të pasurive, duke kryer shtesa në deklaram e aq më tepër pas një kohe të gjatë të kaluar (tri vite). Në këtë mënyrë, nuk mund të kishte kuptim afati i dorëzimit të deklaratës që parashikohet në datën 31 mars të vitit pasardhës, nëse në këto deklarata mund të ndërhyhet me korrigjime në çdo moment. Si rrjedhojë e sa më sipër, mbetet e paqartë mënyra se si është plotësuar/korrigjuar në vitin 2007 deklarata periodike e vitit 2004, duke pasur parasysh distancën kohore të kaluar ndërmjet këtyre viteve.

12.8 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, gjendet vërtetimi nr. {***} prot., datë 25.01.2017, i lëshuar nga shoqëria “{***}” ShA, nëpërmjet të cilit specifikohet numri i aksioneve dhe të ardhurat e përfituara në formë dividendi nga subjekti i rivlerësimit si aksioner i kësaj shoqërie që nga viti 1996. Të ardhurat që ka përfituar subjekti nga tërheqja e fitimit ndër vite, kanë qenë: në vitin 1998, për 7050 aksione, ka përfituar 234.729 lekë; në vitin 2000, për 7050 aksione të zotëruara, ka përfituar 1.721.348 lekë; në vitin 2003, për 5326 aksione, ka përfituar 244.953 lekë; në vitin 2006, për 7872 aksione, ka përfituar 173.484 lekë; në vitin 2007, për 7872 aksione, ka përfituar 304.025 lekë; në vitin 2008, për 7872 aksione, ka përfituar 506.058 lekë; si dhe në vitin 2014, për 3936 aksione, ka përfituar 240.993 lekë.

Në dosjen e ILDKPKI-së gjendet i administruar vërtetimi i datës 26.01.2017, lëshuar nga shoqëria “{***}” ShA, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit Tomor Kullolli, nga viti 1996 deri në vitin 2013, zotëronte 2057 aksione dhe në vitin 2008 ka përfituar nga shpërndarja e dividendit shumën 117.721 lekë, ndërsa nga viti 2013 deri në vitin 2017 ka zotëruar 1028,5 aksione.

12.9 Me përgjigjet e rezultateve të hetimit, dorëzuar në seancën dëgjimore në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dy fletë printime me tabela, me të dhëna lidhur me pagesat e kryera nga {***} për subjektin e rivlerësimit, ndryshimin në vite të kontributit në aksione të subjektit të rivlerësimit në “{***}” ShA, përmbledhje për kontributin gjithsej në kapital, të dhëna mbi fitimet e {***} për vitet 1995-2018 dhe llogaritje mbi dividendin për subjektin e rivlerësimit. Në llogaritjen e dividendit për subjektin e rivlerësimit sipas këtyre të dhënave në tabela, rezulton se për vitet 1995-2013, subjekti ka përfituar dividend në shumën 582.702 lekë, shumë kjo që jo vetëm nuk përkon me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, por as me vërtetimin e lëshuar nga kjo shoqëri, cituar në paragrafin më sipër (117.721 lekë). Këto printime të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore në Komision, nuk kanë të shënuar autoritetin lëshues, as nënshkrime se nga kush janë lëshuar dhe as vulën e shoqërisë. Ndaj për shkak të mungesës së këtyre elementeve, ato nuk plotësojnë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e një shkrese, nga e cila pretendohet të provohet një fakt.

12.10 Kolegji vëren se nga verifikimi në faqen *online* të QKB-së, rezulton se për shoqërinë “{***}” ShA janë depozituar dokumente të periudhave të ndryshme. Në dokumentacionin që i përket vitit 2000, i ngarkuar në sistem, rezulton se vendimi i asamblesë së jashtëzakonshme të aksionerëve të shoqërisë tregtare “{***}” ShA, ka aprovuar raportin e ekspertit kontabël të shoqërisë, si i mbështetur në ligj, duke vendosur zvogëlimin e kapitalit në masën 110.000.000 lekë.

Nga procesverbali i mbledhjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë “{***}” ShA, të mbajtur më datë 31.05.2000, rezulton se aksionerët

kanë votuar “pro” për zvogëlimin e kapitalit në nivelin e 84,28%. Sipas këtij vendimi, vlera e një aksioni dhe përqindja e tyre do të mbetet e pandryshuar. Në këtë procesverbal, në paragrafin e emërtuar “Mbi ndarjen e dividendit”, është shënuar: *Në këtë pikë u shpjegua se si rezultat i veprimtarisë së saj (humbje të mbartura, fitim i realizuar, ndarje dividendi), shoqëria “{***}” ShA ka disponibilitet për ndarje vetëm 6,8 milionë lekë. Aksionerët ishin dakord për të mos proceduar për ndarje dividendi për këtë vit.* Siç lexohet qartësisht nga ky procesverbal që i ka paraprirë vendimit të asamblesë së aksionerëve të shoqërisë, rezulton se për vitin 2000 nuk është ndarë dividend, vendimmarrje e cila është miratuar me 84,28% vota “pro”. Ky dokument i ngarkuar në sistemin *online* të QKB-së, si dokumentacion i shoqërisë për vitin 2000, hedh poshtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit që shoqëria ka ndarë dividend në këtë vit, duke pretenduar se vetë subjekti ka përfituar 1.721.348 lekë. Gjithashtu, sipas shkresës së shoqërisë “{***}” ShA, sqarohet se subjekti i rivlerësimit ka përfituar dividend edhe në vitin 2003, në shumën 244.953 lekë, të cilin nuk e ka deklaruar në deklaratat periodike, ku sipas dokumentacionit që i përket dosjes së ILDKPKI-së, subjekti ka filluar nga viti 2006 të deklarojë fitime të derivuara nga aksionet e dy shoqërive.

12.11 Kolegji vëren se lidhur me çështjen e pagesës së tatimit për dividendët e përfituar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konkluduar se edhe në rast se do të pranohej pretendimi i subjektit mbi disponimin e këtyre kursimeve nga viti 2000 deri në vitin 2004, duke e konsideruar mosdeklarimin e gjendjes *cash* vetëm si një pasaktësi, çka do të binte ndesh me dispozitat ligjore dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, këto të ardhura gjithsesi nuk mund të konsideroheshin me burim krijimi të ligjshëm, për sa kohë nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore mbi këto shuma të përfituara nga subjekti nëpërmjet aksioneve të tij. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se duke mos pasur detyrim për të paguar tatimin, edhe sikur shoqëria të mos e këtë paguar, për të nuk rezulton asnjë përgjegjësi. Detyrimet, sipas nenit 420 të Kodit Civil, lindin nga kontratat dhe nga ligji. Sipas subjektit, nga ligji tatimor nuk i ka lindur ndonjëherë ndonjë detyrim, e për pasojë nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi.

12.12 Në nenin 33, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, varianti fillestar, parashikohet se: *Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, si dhe çdo subjekt tjetër, i njohur si i tillë nga legjislacioni në fuqi, mban në burim tatimin, në masën 15 për qind, për pagesat e mëposhtme:*
a) dividendët, përveç dividendëve të përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 34 të këtij ligji [...]. Siç vërehet në legjislacionin tatimor, tatimi mbi dividendin paguhet nga shoqëria që e ndan atë në formën e fitimit të ortakut, por duke u gjendur në kushtet ku subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion që shoqëria ka shpërndarë dividend, dhe se dividendi i shpërndarë ka qenë në masën që pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se detyrimi për pagesën e tatimit nuk shihet me relevancë për t’u trajtuar, për sa kohë të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, si të krijuara nga dividendi në vitet 2000 dhe 2003, nuk u provuan.

12.13 Kolegji vëren se në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të aksioneve të shoqërive, letra me vlerë të cilat i ka trashëguar, por nuk ka depozituar dokumentacion ligjor që provon se i ka përfituar këto letra me vlerë. Për këtë arsye,

Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të vërë në dispozicion dokumentacionin ligjor që vërteton mënyrën e fitimit të letrave me vlerë që kanë shërbyer për blerjen e aksioneve në shoqëritë “{***}” ShA dhe “{***}” ShA, nga të cilat më pas ka përfituar të ardhura ndër vite. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të këtij pyetësori, ka sqaruar se: *Këto aksione kanë qenë letra me vlerë, të cilat gjyshi, xhaxhai dhe babai i kanë marrë si shpërblim për burgim të padrejtë (kanë qenë të tre të burgosur politikë) dhe pas marrjes së këtyre letrave, i kam regjistruar në blerjen e aksioneve në këto dy shoqëri (nuk ka letra me vlerë të blera nga unë).*

12.14 Sërish Komisioni i ka kërkuar subjektit, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, të vërë në dispozicion dokumentacionin ligjor me anë të të cilit ka përfituar/blerë të drejtën mbi këto letra me vlerë në emër të babait, gjyshit dhe xhaxhait, dhe çmimin përkatës, të cilat më pas i ka përdorur për të blerë aksionet në shoqëritë e sipërpërmendura; të dorëzojë dokumentacionin e përfitimit të këtyre letrave me vlerë dhe të regjistrimit fillestar të tyre në këto shoqëri; si dhe të provojë shumën e saktë të investimit nga ana e subjektit në blerjen e aksioneve në vitin 1996. Lidhur me kërkimet e Komisionit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se: *Nuk kam blerë letra me vlerë, këto letra me vlerë janë përdorur për blerje aksionesh me ankand të mbyllur në vitin 1995 (në shoqëritë “{***}” ShA, Elbasan dhe “{***}” ShA, Elbasan). Letrat me vlerë i ka përfituar babai im H. K. dhe gjyshi im M. K., si dëmshpërblim si të dënuar politikë, ndërsa unë kisha letrat me vlerë të D. K., si trashëgimtar i tij.*

12.15 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit nuk duket konsistent në sqarimet e tij ndaj kërkimeve të Komisionit, pasi në pyetësorin nr. 2 sqaron se letrat me vlerë të gjyshit, babait dhe xhaxhait i ka regjistruar për blerjen e aksioneve, ndërkohë që në pyetësorin nr. 3 të Komisionit, sqaron se kishte vetëm letrat me vlerë të xhaxhait, duke mos qartësuar situatën se letrat me vlerë të kujt përdori, sa ishte vlera e tyre dhe si i përfitoi ato. Subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision formular kërkese për blerje aksionesh në ndërmarrjen “{***}” ShA, Elbasan, datë 25.10.1995, sipas të cilit ka paguar 1.000.000 lekë privatizimin, si dhe formular kërkese për blerje aksionesh në ndërmarrjen “{***}” Elbasan, datë 20.12.1995, ku rezultoi se ka paguar 1.230.401 lekë privatizimin. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision gjithashtu dokumentin “Dëshmi nga gjendja gjyqësore”, datë 29.05.1993, sipas të cilit z. D. K. është dënuar në vitin 1945 me 30 vjet heqje lirie, i cili është ulur në 5 vjet, si dhe “Dëshmi nga gjendja gjyqësore”, datë 06.05.1994, për M. K. (gjyshi i subjektit), sipas së cilës është dënuar në vitin 1947 me 6 muaj burgim.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar legjitimitimin e tij mbi përfitimin e të drejtave mbi letrat me vlerë të babait, gjyshit dhe xhaxhait, në mënyrë që t’i përdorte ato për blerjen e aksioneve në emër të tij. Gjithashtu, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues mbi vlerën e tyre, por ka depozituar vetëm shumën e investuar prej tij në blerjen e aksioneve me anë të formularëve të kërkesës për blerje aksionesh, të cilët nuk janë të shoqëruar me urdhërshirimet që janë cituar në këta formularë. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar, në cilësinë e provës në Komision, një urdhërshirim të datës 20.12.1995, sipas të cilit R. K.⁹ i ka kaluar letrat me vlerë privatizimi Tomorr Kullollit, në shumën 901.153 lekë. Përveç këtij dokumenti,

⁹ Sipas certifikatës familjare të datës 17.04.2013, e cila pasqyron gjendjen familjare të datës 01.08.1991, rezultoi të jetë gjyshja e subjektit të rivlerësimit.

subjekti nuk ka dorëzuar prova të tjera për të provuar përfitimin e këtyre letrave me vlerë nga xhaxhai dhe babai i tij. Në dosjen e ILDKPKI-së gjendet e administruar “Dëshmia e trashëgimisë”, datë 12.06.1993, e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gramsh, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit është trashëgimtar ligjor i trashëgimlënësve D. K. dhe R. K., i cili trashëgon gjithë pasurinë e tyre. Përveç këtij akti që e njeh subjektin e rivlerësimit si trashëgimtar të trashëgimlënësve të cituar më sipër, trupi gjykues konstatoi se subjekti nuk dorëzoi në Komision asnjë akt që të provojë sasinë e letrave me vlerë që ka përfituar nga D. K., duke mbetur në nivel deklarativ pretendimi i subjektit për përfitimin e tyre.

12.16 Në përfundim të analizës së shkakut të ankimit që u përket burimeve që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 67,4 m², trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi se kishte pasur gjendje *cash* në banesë në momentin e blerjes së këtij apartamenti, të cilin pretendoi se e përdori si burim të blerjes së kësaj pasurie. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues se ka përfituar dividendin në shumën prej 1.721.384 lekësh nga shpërndarja e fitimit të shoqërisë “{***}” ShA, pasi nuk dorëzoi dokumentacion mbështetës që e ka poseduar këtë shumë, përveç vërtetimit të kësaj shoqërie, të cilin e ka lëshuar në datën 25.01.2017, për t’i shërbyer procesit të rivlerësimit. Përpos këtij fakti, nga dokumentacioni që disponon QKB *online*, rezultoi e provuar se shoqëria në vitin 2000 nuk kishte shpërndarë dividend.

12.17 Përveç sa më sipër, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit provoi se është trashëgimtar i vetëm i xhaxhait të tij, z. D. K., por mbeti në nivel deklarativ pretendimi i tij se nëpërmjet trashëgimisë, ka përfituar letrat me vlerë të xhaxhait, duke i përdorur si burim për blerjen e aksioneve në shoqëritë tregtare. Po ashtu, lidhur me pretendimin se ka përfituar letra me vlerë nga babai i tij, nuk provoi sasinë që ka përfituar, por subjekti i rivlerësimit provoi vetëm koston e aksioneve që ka blerë në dy shoqëritë, duke pamundësuar në këtë mënyrë kontrollin e ligjshmërisë së të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtyre aksioneve. Si rrjedhojë e këtyre rrethanave, trupi gjykues e vlerësoi të drejtë qëndrimin e Komisionit që e ardhura e pretenduar si e fituar nga subjekti nga shpërndarja e dividendit nga shoqëria “{***}” ShA në vitin 2000, të cilën ai pretendoi se e kishte gjendje *cash* në banesë, dhe se i ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2004, të mos përfshihet në analizën financiare sipas pretendimit të tij. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga kontrolli që Kolegji i bëri analizës financiare të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi për të mbuluar me të ardhura nga burime financiare të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe blerjen e apartamentit në periudhën janar deri shtator 2004, për një diferencë negative në shumën 1.572.552 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 13. Lidhur me pasurinë “shtëpi private dykatëshe”,** ndodhur në lagjen “{***}”, Elbasan, subjekti i rivlerësimit pretendon se për blerjen e kësaj pasurie, kanë shërbyer si burim disa kontrata huaje, të marra në vitin 2006, deklaruar në DIPP-në e këtij viti. Subjekti sqaron se ka marrë hua gjithsej në masën 6.000.000 lekë, nga personat A. A. , S. M. , P. Xh., A. Xh. dhe nga A. K., dhe se nuk është i drejtë vendimi i Komisionit se nuk është provuar burimi i ligjshëm i asnjërit prej huadhënësve, pasi nga provat e paraqitura, provohet fakti se huadhënësit kanë pasur mundësi financiare për t’i dhënë hua subjektit shumat respektive. Nga Komisioni pranohet marrja prej subjektit e huave, pasi

llogarit si shpenzim në vitet e mëpasshme shlyerjet e tyre. Sipas subjektit, huadhënësit kanë pasur burime të ligjshme për huatë e dhëna, pasi i kanë përfituar nga aktivitetet e ligjshme që janë kryer në Shqipëri dhe nga puna në emigracion. Sipas subjektit, asnjë nga të afërmit që i ka dhënë hua, nuk është dënuar ndonjëherë për ndonjë vepër penale në bazë të së cilës të kishte nxjerrë të ardhura të paligjshme. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk ka pasaktësi në deklarin e huasë për S. M. në vitin 2006 dhe përfundimisht, për këtë pasuri, pretendoi se ka pasur mundësi ta blejë atë.

13.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Komisioni nuk është shprehur dhe ka kaluar barrën e provës për ngritjen e dyshimeve mbi një fiktivitet të huave – për sa kohë subjekti i ka deklaruar si burime dhe si shpenzime në fazën e kthimit pas ndër vite – por është kërkuar të provohet burimi i ligjshëm i shumave të përfituara nga subjekti nëpërmjet huazimeve në fjalë. Në këto kushte, dështimi për të provuar burimin e ligjshëm të huadhënësve nuk passjell shuarjen e efekteve financiare të dhënies dhe kthimit të huasë (sipas deklarimeve të subjektit), por vetëm moskonsiderimin si të ligjshme të përfitimeve nga huatë dhe verifikimin e mundësive financiare për kthimin pas të tyre përgjatë viteve dhe në masat e deklaruara nga subjekti.*

Megjithatë, trupi gjykues vëren se, edhe nëse do të pranohej kërkesa e subjektit për të mos i përlllogaritur në analizën financiare shumat e deklaruara prej tij si shpenzime për kthimin pas ndër vite të huave, rezultati për periudhën e interesuar (2007 – 2011) do të përmirësohej me 3.107.245 lekë, por gjithsesi bilanci i përgjithshëm negativ do të mbetej në nivele shumë të larta, ndonëse i përmirësuar. Nga ana tjetër, edhe në rast se do gjendej i bazuar ky pretendim i subjektit, nuk do të ndryshonte asgjë lidhur me burimet financiare për pasurinë në analizë, pasi sërish do të konsistonte në një pamundësi financiare në masën 6.708.671 lekë, për sa kohë kthimi i huave është kryer në vitet e mëpasshme.

13.2 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shtëpi private dykatëshe, ndodhur në lagjen “{***}”, me sip. truall 260,87 m² dhe sipërfaqe ndërtesë 88,75 m² për çdo kat, marrë hua dhe kredi të shlyera ndër vite, vlera 6.800.000 lekë”.

Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shtëpi private në lagjen “{***}”, Elbasan, me sipërfaqe truall 255 m² dhe ndërtesë 89 m² sipas kontratës së shitjes nr.{***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 25.09.2006, në vlerën 6.800.000 lekë”.

Në rubrikën e përshkrimit të detyrimeve, subjekti i rivlerësimit ka përshkruar se ka marrë hua për blerjen e shtëpisë.

13.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, pasuria e llojit “ndërtesë”, me sip. 89 m² dhe truall me sip. 255 m² është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2006, pa e deklaruar burimin financiar të krijimit të saj, por në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar disa huamarrje për blerjen e banesës në fjalë dhe konkretisht në vlerat dhe nga individët si më poshtë përshkruar:

1. A. A. , dhënë hua në vlerën 2.000.000 lekë;
2. S. M. , dhënë hua në vlerën 2.000.000 lekë;
3. A. Xh., dhënë hua në vlerën 1.000.000 lekë;
4. P. Xh., dhënë hua në vlerën 1.000.000 lekë;
5. A. K., dhënë hua në vlerën 5.000 euro.

13.4 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka lidhur tri kontrata shitblerjeje për pasurinë objekt shqyrtimi:

(i) Kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 25.09.2006, me palë shitëse Ll. e V. B. dhe palë blerëse L. K., për blerjen e dy pasurive, përkatësisht trualli me sip. 105,52 m², dhe apartamenti në katin e parë të ndërtesës me sip. 88,75 m², kundrejt çmimit total 3.000.000 lekë.

(ii). Kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 25.09.2006, lidhur ndërmjet palës shitëse Ll. e V. B. dhe palës blerëse L. K., për pasurinë e llojit “truall”, me sip. 88,75 m², kundrejt çmimit 1.000.000 lekë.

(iii). Kontratë shitblerjeje nr. {***}, datë 25.09.2006, me palë shitëse R. E. e R. Rr. dhe palë blerëse L. K., për blerjen e dy pasurive, përkatësisht trualli me sip. 66,6 m², dhe kati i dytë i ndërtesës me sip. 88,75 m², kundrejt çmimit prej 2.800.000 lekësh.

13.5 Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen pjesërisht të huave në shumën 3.104.550 lekë, përkatësisht nga 1.000.000 lekë shtetasve A. A. dhe P. Xh., 500.000 lekë shtetasit A. Xh. dhe 5.000 euro ndaj shtetasit A. K., si dhe marrjen e kredisë në shumën 2.500.000 lekë në Raiffeisen Bank, me qëllim “për blerje shtëpie”. Bashkëlidhur dokumentacionit të kredisë së dërguar në Komision nga banka, ndodhet një deklaratë¹⁰ noteriale e S. M., i cili ka deklaruar se i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 2.500.000 lekë për blerjen e shtëpisë, shumë e cila do t’i kthehej me anë të kredisë bankare në Raiffeisen Bank, dega Elbasan.

13.6 Komisioni konstatoi mospërputhje të shumës së huasë së dhënë nga z. M., të deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2006 (2.000.000 lekë) dhe shumës së përshkruar në deklaratën noteriale të sipërcituar (2.500.000 lekë), dhe e pyeti subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë mospërputhje në pyetësorin nr. 2. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të këtij pyetësi, ka sqaruar se shuma prej 2.000.000 lekësh është marrë hua në vitin 2006, ndërsa shuma prej 500.000 lekësh është marrë në vitin 2007 dhe është shlyer me kredinë e marrë në të njëjtin vit. Ndërkohë në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar shlyerjen e huasë ndaj individëve të tjerë dhe detyrimin e shtetasit S. M. prej 2.000.000 lekësh si të palikuiduar.

13.7 Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektin të rivlerësimit të paraqesë dokumentacion ligjor që të provojë kohën dhe mënyrën e marrjes apo të dhënies së huave, si dhe dokumentacion ligjor që të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të secilit prej huadhënësve. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “Të gjithë huamarrësit në dijeninë time kanë pasur burime të ligjshme për dhënien e shumave të sipërcituara, ndërsa lidhur me burimin e ligjshëm të shlyerjes nga ana ime, sqaroj se një pjesë është likuiduar nga kredia e marrë në korrik 2007 pranë Raiffeisen Bank dhe pjesa tjetër ndër vite, të pasqyruara këto si në deklarata vjetore, dhe në deklaratën *vetting*. Lidhur me pyetjen mbi dokumentacionin ligjor që provon kohën dhe mënyrën e dhënies së huasë, si dhe të kthimit pas të shumave, sqaroj se të gjithë huamarrësit janë persona me lidhje fafaisnore me mua ose bashkëshorten time dhe nuk kam nënshkruar kontratë pasi janë dhënë në mirëbesim, ndërsa koha e dhënies së kësaj huaje është shtator 2006”.

¹⁰ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 30.05.2007.

13.8 Burimi i krijimit të kësaj pasurie, siç është përshkruar më lart, në mënyrë indirekte është deklaruar në DIPP-në e vitit 2006 nga huatë e marra nga pesë individët e cituar në paragrafin 13.3 më sipër. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve, të cilët kanë mundësuar më pas dhënien e këtyre huave në favor të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor për të provuar mundësinë e dhënies së këtyre huave, as me përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe 3, për rrjedhojë, këto shuma nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni në analizën financiare. Duke u nisur nga sa ka rezultuar, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrë prove lidhur me këtë pasuri, për dy gjetje: (i) Duket se ka mospërputhje midis vlerës së huasë së deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2006 nga S. M. , krahasuar me vlerën e huasë së përshkruar në deklaratën noteriale të vitit 2007. (ii) Duket se për blerjen e pasurive në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme në masën -6.708.671 lekë.

13.9 Lidhur me barrën e provës së kaluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në seancën dëgjimore¹¹ në Komision prapësimet mbi rezultatet e hetimit, i cili lidhur me këtë pasuri dhe për gjetjet lidhur me të ka sqaruar se: “Në DIPP-në e vitit 2006 kam deklaruar si hua nga S.M. shumën 2.000.000 lekë. Për nevoja të mia, kam marrë në fillim të vitit 2007 edhe një shumë prej 500.000 lekësh, të cilën ia kam kthyer po në vitin 2007. Për kthimin pjesërisht të huasë së tij dhe të huave të tjera, kam marrë kredi në shumën 2.500.000 lekë në Raiffeisen Bank. Me këtë dhe të ardhurat e siguruara nga paga, i kam kthyer shumat përkatëse huamarrësve A. A. dhe P. Xh. nga 1.000.000 lekë, A. Xh. 500.000 lekë dhe A. K. 5000 euro. Shuma prej 500.000 lekësh e marrë hua nga S.M. në vitin 2007, duhet të jetë përdorur për shlyerjen e një prej huave të tjera, dhe kur kam marrë kredinë, atij ia kam kthyer të njëjtën shumë. Për pasojë, kredia prej 2.500.000 lekësh mbetet sikur të jetë e gjitha për huamarrësit e tjerë [...]”.

13.10 Kolegji vëren se përveç sa më sipër deklaruar në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se në vitin 2007, mbeten pa u kthyer shumat 2.000.000 lekë z. S. M. , 1.000.000 lekë z. A. A. dhe 500.000 lekë z. P. Xh., dhe detyrimi për kthimin e kredisë në Raiffeisen Bank. Pra, ndaj huamarrësve, subjekti sqaron se mbeti debitor në masën 3.500.000 lekë në vitin 2007. Në vitin 2008 ka shlyer hua në shumën 1.000.000 lekë e për pasojë detyrimi në fund të vitit 2008, mbeti 2.500.000 lekë, aq sa është deklaruar në DIPP-në e vitit 2008. Në vitin 2009 ka shlyer hua në masën 500.000 lekë e në fund detyrimi për t’u shlyer, mbeti 2.000.000 lekë, aq sa është deklaruar në DIPP-në e vitit 2009. Në vitin 2010 ka shlyer hua në masën 500.000 lekë e në fund detyrimi për t’u shlyer mbeti 1.500.000, aq sa është deklaruar në DIPP-në e vitit 2009. Në vitin 2011 ka shlyer hua në masën 1.000.000 lekë e në fund të vitit, detyrimi mbeti 500.000 lekë, aq sa është deklaruar në DIPP-në e vitit 2011. Në vitet pasardhëse, deri në vitin 2015, subjekti shpjegon se nuk i kujtohet koha e saktë e shlyerjes së huasë, por shuma e mbetur ka qenë në masën 500.000 lekë. Sipas subjektit, duke qenë se pagesat e bëra për shlyerjen

¹¹ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegimet mbi rezultatet e hetimit në seancë dëgjimore në Komision dhe jo në afatin e përcaktuar nga Komisioni kur i ka kaluar barrën e provës, pasi subjekti ka pretenduar që procesi i tij i rivlerësimit të pezullohet deri në marrjen e një vendimi nga KLGj-ja lidhur me kërkesën e tij për pension të parakohshëm.

e huave në një rast të vetëm, nuk kanë kaluar 300.000 lekë, nuk ka pasur detyrim ligjor për ta specifikuar si zë të veçantë të deklaramit periodik, por e ka përfshirë në shpenzimet totale, për këtë shkak, subjekti nuk e ka deklaruar si detyrim në deklaratën *vetting*, pasi nuk e kishte në kohë këtë detyrim.

13.11 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit lidhur me mundësinë e dhënies së huave nga huadhënësit, ka shpjeguar në prapësimet e rezultateve të hetimit, si dhe në ankim, se S. M. ka qenë pronar i shoqërisë tregtare "{***}" ShPK, e regjistruar në QKR që nga viti 1999 dhe ka pasur të ardhura për të dhënë huanë. Vlera e kapitalit të shoqërisë është 32.650.000 lekë, çka tregon se ka pasur mundësi financiare për të dhënë huanë, e cila është ndjeshëm më e ulët se vlera e kapitalit themeltar. Për huadhënësin A. A. , subjekti ka argumentuar se ka qenë pronar i shoqërisë tregtare "{***}" ShPK, e regjistruar në QKR që nga viti 2009, me vlerë kapitali 100.000 lekë. Para regjistrimit të shoqërisë, ka qenë i regjistruar si person fizik me të njëjtin objekt prej vitit 1992 dhe ka pasur të ardhura për të dhënë huanë. Personi nuk jeton më, ndaj bashkëshortja e tij ka lëshuar deklaratë noteriale për njohjen e huasë dhe mundësitë e dhënies së saj. Për huadhënësin A. Xh., subjekti ka argumentuar se ka punuar në Greqi dhe huanë prej 1.000.000 lekësh e ka tërhequr nga banka dhe ia ka dhënë *cash* subjektit. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar një librezë kursimi të çelur në një bankë greke, prej së cilës pretendon se ka provuar që huadhënësi ka pasur kursime, si dhe kohën e tërheqjes së shumës. Për huadhënësin A. K., subjekti ka argumentuar se ka punuar në Greqi nga viti 1991 dhe nga puna, ka siguruar të ardhura. Shumën 5.000 euro ia ka sjellë nga Greqia nëpërmjet bankës, kunatit të subjektit A. Xh.. Edhe për huadhënësin P. Xh., subjekti ka argumentuar se ka pasur mundësi ta japë huanë, pasi ka punuar në ekonominë e tij shtëpiake dhe veç të tjerave, ka pasur edhe një kioskë. Për dhënien e huasë, ka lëshuar edhe një deklaratë noteriale.

Sipas subjektit, me huanë dhe të ardhurat që kishte vetë nga paga e tij dhe e bashkëshortes, qoftë edhe vetëm të vitit 2006, ka pasur mundësi të blejë banesën. Subjekti shpjegon se nuk ka deklaruar kursime *cash* në banesë në fund të vitit 2004 dhe në fund të vitit 2005, sepse ashtu e ka kuptuar procesin e deklaramit të pasurisë, vetëm si proces i deklaramit të të ardhurave.

13.12 Lidhur me burimin e të ardhurave të huadhënësve, si persona tjerë të lidhur, për shkak të marrëdhënies së huasë së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe detyrimit në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të cilat kanë mundësuar dhënien e huave, subjekti i rivlerësimit, për të provuar mundësinë e dhënies së huasë prej 2.000.000 lekësh, nga A. A. , ka dorëzuar në seancë dëgjimore në Komision, bashkë me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, deklaratën noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.02.2015, të deklarueses V. A., e cila, sipas certifikatës familjare të datës 03.06.2021, që paraqet gjendjen familjare të vitit 2009, figuron të jetë bashkëshortja e huadhënësit A. A. . Sipas kësaj deklarate, znj. A. sqaron se në vitin 2006, i ka dhënë hua të afërmit Tomorr Kullolli, shumë prej 2.000.000 lekësh, pa interes dhe afat, që t'ia kthejë sipas mundësive të tij financiare. Sipas kësaj përmbajtjeje të deklaratës, bashkëshortja e huadhënësit ka konfirmuar marrëdhënien e huasë, por nuk ka provuar mundësinë e dhënies së kësaj huaje subjektit të rivlerësimit. Ky i fundit paraqiti në Komision edhe ekstraktin e regjistrimit në QKB për të dhënat e shoqërisë "{***}" ShPK, me

administrator A. A., i cili është babai i huadhënësit A. A. , dhe ortakë A. dhe J. A., fëmijët e A. A., si dhe V. A., bashkëshortja e huadhënësit. Kjo shoqëri rezulton se është themeluar në datën 26.01.2009, ndërsa huaja është marrë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006, pra tri vite para se të krijohej shoqëria tregtare. Me dokumentacionin që ka paraqitur, subjekti i rivlerësimit nuk provon mundësinë e personit tjetër të lidhur, z. A. A., për burime financiare të ligjshme në dhënien e kësaj huaje.

13.13 Për mundësinë e dhënies së huasë prej 2.000.000 lekësh nga huadhënësi S. M. , subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision vetëm ekstraktin e QKB-së për shoqërinë “{***}” ShPK. Nga kërkimi në faqen zyrtare të QKB-së, rezulton se nga shoqëria “{***}” ShPK janë depozituar pasqyrat financiare për vitin 2007, në të cilat evidentohet fitimi i kësaj shoqërie edhe për vitin paraardhës. Për vitin 2006, fitimi neto i shoqërisë rezulton të ketë qenë në shumën 1.120.540 lekë. Ky fitim i përket periudhës janar-dhjetor 2006, ndërsa huaja e dhënë subjektit të rivlerësimit, ka shërbyer si burim për likuidimin e banesës së blerë në datën 25.09.2006, si rrjedhojë kjo shumë nuk do të ishte e mjaftueshme për të mbuluar huanë prej 2.000.000 lekësh, subjektit të rivlerësimit. Ky dokumentacion i paraqitur nga subjekti në kuadër të detyrimit që lind nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk provon mundësinë e personit tjetër të lidhur, z. S. M. , për burime financiare të ligjshme në dhënien e kësaj huaje.

Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kapitali i shoqërisë “{***}” ShPK është 32.650.000 lekë dhe është ndjeshëm më i lartë se huaja e dhënë ndaj subjektit, nga verifikimi i të dhënave të shoqërisë “{***}” ShPK në faqen zyrtare të QKB-së, rezulton se në vitin 2006, kapitali i nënshkruar i shoqërisë ka qenë në masën 5.500.000 lekë dhe ka qenë i tillë deri në vitin 2015, i cili më pas ka filluar të rritet dhe në vitin 2016, ka arritur në vlerën 32.650.000 lekë, periudhë kjo e cila nuk përkon me kohën e marrjes së huasë nga subjekti i rivlerësimit, për më tepër që vlera e kapitalit, kur është më e madhe se ajo e huadhënies, nuk prezumon disponibilitetin e burimeve financiare të huadhënësit për dhënien e huasë subjektit të rivlerësimit.

13.14 Për mundësinë e dhënies së huasë prej 1.000.000 lekësh nga huadhënësi A. Xh., subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision një librezë kursimi në emër të individit A. Xh., për të cilin nuk solli asnjë dokument për të provuar se është i njëjti person me huadhënësin. Në këtë librezë rezulton se në datën 21.09.2006, është depozituar shuma 10.000 euro nëpërmjet dy depozitimeve me nga 5.000 euro dhe po në të njëjtën datë, është tërhequr shuma prej 10.000 eurosh. Në librezë evidentohet se në datën 25.09.2007, është depozituar shuma prej 10.000 eurosh, e cila është tërhequr dy ditë më pas, si rrjedhojë gjendet i drejtë arsyetimi i Komisionit se edhe nëse libreza e kursimit do të ishte në emër të huadhënësit, disponibiliteti i shumës 10.000 euro nuk mjafton për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për huadhënien në favor të subjektit të rivlerësimit.

13.15 Për mundësinë e dhënies së huasë prej 1.000.000 lekësh nga huadhënësi P. Xh., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision një deklaratë noteriale të huadhënësit, me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.02.2015, i cili deklaron se i ka dhënë kunatit të tij Tomorr Kullolli shumën 1.000.000 lekë në muajin prill 2006. Sipas deklaruesit, kjo hua është dhënë pa afat dhe pa interes. Edhe sipas kësaj përmbajtjeje të deklaratës, huadhënësi ka konfirmuar marrëdhënien e

huasë, por nuk ka provuar mundësinë e burimeve financiare të ligjshme për dhënien e kësaj huaje subjektit të rivlerësimit.

Sa i përket huasë prej 5.000 eurosh, dhënë nga huadhënësi A. K., subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për mundësinë e burimeve financiare të ligjshme për dhënien e huasë në kuadër të detyrimit që i lind nga parashikimi i nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

13.16 Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji vëren se dokumentacioni që ka dorëzuar subjekti i rivlerësimit për të provuar mundësinë e dhënies së huave nga personat e tjerë të lidhur, të cilat kanë shërbyer si burim financiar për likuidimin e banesës së blerë në vitin 2006, nuk provoi sasinë e të ardhurave dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre, si detyrim që buron nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerësoi se për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësinë e dhënies së huave me burime financiare të ligjshme, gjendet i drejtë konkluzioni i Komisionit për të mos i përfshirë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare të vitit 2006. Në përfundim të analizës së këtij shkak ankimi, nga kontrolli që Kolegji i bëri analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kishin mundësi të kryenin blerjen e pasurisë dhe përballimin e shpenzimeve në vitin 2006, për diferencën negative në shumën -6.476.662 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 14. Lidhur me pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 134 m², ndodhur në Tiranë**, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka shpjeguar bindshëm ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit argumenton se me vendimin penal, datë 11.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka paraqitur në Komision, provohet fakti se babai i tij ka pasur burime të ligjshme për dhurimin e shumës 9.300.000 lekë subjektit në vitin 2012. Sipas subjektit të rivlerësimit, pushimi i procedimit penal nga prokuroria dhe gjykata provon ligjshmërinë e të ardhurave të babait dhe për këtë shkak, edhe shuma e përfituar si dhurim, buron nga të ardhura të ligjshme. Lidhur me burimin tjetër që përbën të ardhurat nga shitja e tokës në vitin 2013, subjekti pretendon se mbulohet tërësisht blerja e banesës në vitin 2014. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat janë përfituar përpara kthimit të tokës me vendim të AKP-së, por posedimin e tokave, babai i tij e ka marrë që në fillim të viteve ‘90, pasi zotëronte aktin e vjetër të pronësisë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se nuk provohet marrëdhënia e qirasë e babait me blegtorët, është i pabazuar dhe këtë e provon vendimi i pushimit të çështjes penale nr. {***}. Lidhur me pagimin e tatimit për qiranë e tokës, subjekti shpjegon se detyrimin për kryerjen e pagesës e ka pasur babai i tij, dhe nëse nuk posedon prej tij ndonjë dokument që provon këtë fakt, nuk do të thotë se kjo pagesë nuk është kryer.

14.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Trupi gjykues vlerëson se, ndonëse subjekti është pyetur në mënyrë të përsëritur dhe ka pasur mjaftueshëm kohë në dispozicion, përfshi edhe kohën shtesë që kërkoi dhe iu dha, nuk ka paraqitur prova direkte mbi burimet e ligjshme financiare për pagesat e kryera për këtë pasuri, madje ka anashkuar këtë detyrim që mbart në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, duke i referuar/cituar në mënyrë të përgjithshme Komisionit ekzistencën e vendimeve penale, që sipas tij kanë konstatuar ligjshmërinë e burimeve financiare për krijimin*

e pasurive të tij. [...] Për sa kohë dispozitat kushtetuese dhe ligjore parashikojnë detyrimin e subjekteve për të përmbysur barrën e provës, duke paraqitur në procesin e rivlerësimit prova konkrete, specifike dhe ligjore mbi burimet e ligjshme të pasurive të tyre, ky detyrim nuk mund të anashkalohet me referim të akteve të një tjetër natyre juridike (madje pa i paraqitur ato), dhe as me kërkesa “deleguese” ndaj Komisionit, për t’i gjetur dhe konsideruar si prova shteruese ato. [...] Për rrjedhojë, në konkluzion, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues çmon se prej subjektit nuk janë paraqitur prova mbi burime financiare të ligjshme shtesë, veç atyre që Komisioni ka vlerësuar dhe se rezultatet e hetimit administrativ të njoftuara, nuk mund të ndryshojnë, duke konfirmuar një pamundësi financiare të subjektit, në vlerën negative prej 7.512.680 lekësh në vitin 2011 dhe prej 1.042.660 lekësh në vitin 2014. [...] Përfitimi i të ardhurave nga qiradhënia e tokave, që as nuk legjitimohej zotërimi i tyre – sikurse është pohuar nga subjekti – nuk lë hapësirë për cilësimin e shumave të pretenduara si të përfituara, si të ligjshme. Gjithashtu, nuk është provuar asnjë marrëdhënie kontraktore përgjatë periudhës së referuar, që të mund të mbështeste burimin formal të përfitimeve, sikurse nuk është provuar – madje as nuk është pretenduar – pagimi i detyrimeve tatimore për këto të ardhura. Për më tepër, të ardhurat e pretenduara nga qiradhënia janë përfitur në një kohë më të hershme se kthimi pas i tokës babait të subjektit, nga organet përkatëse dhe, për rrjedhojë, nuk ka qenë pronar i ligjshëm i pasurisë së dhënë me qira. Për sa më lart, trupi gjykues çmon se babai i subjektit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, së paku në masën 6.289.057 lekë, për të mundësuar dhurimin e shumës prej 9.300.000 lekësh, në favor të subjektit të rivlerësimit.

14.2 Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament 134,2 m², pasuria nr. {***}, ndodhur në {***}, zona kadastrale nr. {***}, Bashkia Tiranë, me burim nga të ardhurat familjare, me vlerë 69.371 euro.

Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Blerë apartament dubleks në Tiranë, me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.04.2014, me vlerë 69.371 euro. Shitur aksione me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2014, në vlerën 2.755.200 lekë.

Shitur aksione me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2014, në vlerën 1.028.500 lekë.

Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Dhuruar nga babai (marrë nga dëmshpërblimi) 400.000 lekë.

14.3 Kolegji vëren se nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2014, si pasuri e blerë me çmimin 69.371 euro, së cilës nuk i është deklaruar burimi i krijimit të saj, ndërsa në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat familjare. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se me kontratën e shitjes së pasurisë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.04.2014, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka blerë nga pala shitëse “{***}” ShPK, apartamentet me sipërfaqe 70,6 m², për çmimin 33.009 euro, si dhe apartament me sip. 63,6 m² me çmimin 36.362 euro, vlera të cilat, sipas përcaktimeve të kontratës së shitblerjes, janë likuiduar jashtë zyrës noteriale.

14.4 Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se në datën 08.12.2011, të njëjtat palë kishin nënshkruar kontratë “Për ndërtim apartamenti” me nr. {***} prot., për porositjen e një apartamenti me sip. 159,7 m², kundrejt çmimit total prej 155.707,5 eurosh, nga ku kësti i parë, në vlerën 107.600 euro, do të paguhej me nënshkrimin e kontratës, ndërsa pjesa tjetër prej 48.107,5 eurosh do të likuidohej deri në datën 15.01.2012. Pasi u pyet nga Komisioni për arsyet e mosdeklarimit të pasurisë në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo kontratë nuk është deklaruar, pasi është anuluar, për këtë arsye ka deklaruar vetëm pasurinë e regjistruar në vitin 2014. Subjekti ka paraqitur dokumentin “Revokim kontrate” me nr. {***} prot., datë 25.09.2012, të lidhur me shoqërinë ndërtuese “{***}” SHPK, e cila ka për objekt revokimin e kontratës për ndërtim apartamenti me nr. {***} prot., datë 08.12.2011.

Sipas dokumentit “Revokim kontrate”, palët janë dakordësuar se për shkak të pozicionit të apartamentit, pala porositëse do të rezervonte një apartament tjetër dhe shuma e parapaguar prej 59.000 eurosh, do të përdorej për rezervimin e një apartamenti të ri. Komisioni pyeti sërish subjektin e rivlerësimit me anë të pyetësorit nr. 3, për arsyet e mosdeklarimit në DIPP-në e vitit 2011, të kontratës së porositjes së apartamentit dhe kryerjes së pagesës prej 59.000 eurosh, për sa kohë revokimi i kontratës është kryer 1 vit më pas, si dhe i kërkoi të paraqiste të gjitha mandatpagesat që disponon dhe deklarimin e burimit të të ardhurave të përdorura për kryerjen e kësaj pagese në vitin 2011. Subjekti shpjegoi se duke mos qenë kontratë efektive, nuk e ka deklaruar dhe nuk disponon mandatpagesa, ndërsa burimi i të ardhurave është sipas deklarimeve ndër vite, duke mos dorëzuar asnjë dokumentacion për burimin e krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e kësaj pagese.

14.5 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se UKT-ja ka informuar¹² se në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. L. K., figuron e regjistruar një kontratë për abonent familjar, në datën 12.05.2014, me adresë “{***}”, Tiranë, për çeljen e së cilës është depozituar kontrata për ndërtim apartamenti me nr. {***} prot., datë 08.12.2011, kontratë kjo e cituar në paragrafin më sipër si e revokuar nëpërmjet kontratës nr. {***} prot., datë 25.09.2012.

14.6 Komisioni analizoi burimin e krijimit të apartamentit, duke i konsideruar subjektin të rivlerësimit si të paguar në vitin 2011, këstin e parë prej 59.000 eurosh për pagesën e apartamentit, kontrata e të cilit është revokuar. Nga kjo analizë, subjekti i rivlerësimit rezultoi me diferencë negative në vitin 2011, për shumën 7.512.680 lekë. Duke qenë se në kontratën e shitblerjes për apartamentin dubleks, është përcaktuar se çmimi i apartamentit është likuiduar jashtë zyrës noteriale, si dhe duke qenë se në revokimin e kontratës me nr. {***} prot., datë 25.09.2012, me shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK, ishte përcaktuar që kjo shumë do të shërbente për pagesën e çmimit të pasurisë apartament dubleks, Komisioni kreu analizën për mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, për të kryer pagesën e diferencës së mbetur të çmimit, e cila rezulton të jetë 10.371 euro (69.371 euro - 59.000 euro të parapaguara në 2011), në datën e kryerjes së pagesës së këstit të fundit për blerjen e apartamentit më 25.04.2014. Nga verifikimi i veprimeve bankare të subjektit dhe të bashkëshortes së tij, përgjatë periudhës 01.01.2014 – 25.04.2014,

¹² Shkresa e UKT-së nr. {***} prot., datë 18.02.2020.

rezulton se kanë kryer tërheqje nga llogaritë e tyre, në shumën totale prej 288.000 lekësh. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shitur gjysmën e aksioneve të tij në shoqëritë “{***}” ShA dhe në “{***}” ShA, nëpërmjet kontratave noteriale të deklaruara nga subjekti në DIPP-në e vitit 2014 (cituat në paragrafin 14.2 më sipër). Sipas dokumentacionit që gjendet i publikuar në faqen e QKB-së për shoqërinë “{***}” ShA, rezulton dokumenti “Raport mbi shpërndarjen e aksioneve për shoqërinë “{***}””, i datës 02.02.1996, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit zotëronte 7050 aksione, të cilat i ka blerë me çmimin prej 1.230.401 lekësh. Sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 17.04.2014, subjekti i rivlerësimit ka shitur 3936 aksione blerësit Sh. K. (vëllai i subjektit) për çmimin 2.755.200 lekë.

Gjithashtu, sa i përket shoqërisë “{***}” ShA, subjekti i rivlerësimit ka blerë fillimisht 663 aksione për çmimin 663.000 lekë, ndërsa sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 17.04.2013, subjekti i rivlerësimit i ka shitur 1028,5 aksione blerësit Sh. K. për çmimin 1.028.500 lekë.

14.7 Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, lidhur me mënyrën dhe kohën e pagesës së shumës prej 3.803.700 lekësh, të përfituar nga shitja e aksioneve, si dhe nëse janë kryer pagesat e detyrimeve tatimore përkatëse për fitimet e realizuara nga shitja e aksioneve të shoqërive “{***}” ShA dhe “{***}” ShA. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *Aksionet ia kam shitur vëllait dhe jemi likuiduar, por duke qenë në këto marrëdhënie, nuk kemi mbajtur dokumentacion lidhur me shlyerjen detyrimit.*

Në nenin 8, pika 1, shkronja “f” e ligjit nr. 8438, datë 31.12.1998, i ndryshuar “Për tatimet mbi të ardhurat”, parashikohet: *Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: [...] f. të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksioner zotëron dhe ia shet një personi tjetër.* Sipas dokumentacionit të administruar në dosje, subjekti i rivlerësimit ka krijuar të ardhura nga diferenca pozitive e realizuar nga shitja në blerje e një pjese të aksioneve të shoqërive, për të cilat, sipas dispozitës së cituar më sipër, kishte detyrimin të paguante tatimin mbi fitimin e gjeneruar. Subjekti i rivlerësimit jo vetëm që nuk sqaroi në ç’mënyrë i kishte marrë lekët e shitjes së tyre, por nuk dha asnjë sqarim lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore. Përveç faktit se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ardhurat që kishin shërbyer për blerjen e këtyre aksioneve (analizuar më sipër në këtë vendim), nuk provoi me dokumentacion ligjor as shlyerjen e detyrimeve tatimore lidhur me fitimet e realizuara nga shitja e aksioneve, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si rrjedhojë e sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se gjendet i bazuar konkluzioni i Komisionit për të mos i konsideruar këto të ardhura me burim të ligjshëm në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

14.8 Kolegji vëren se Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, duke qenë zotërues aktiv i aksioneve të shoqërive “{***}” ShA dhe “{***}” ShA, ndërkohë që ishte duke ushtruar detyrën e gjyqtarit. Kolegji vëren se Komisioni në paragrafin 128 të vendimit ka konkluduar se duke u nisur nga rezultati financiar i analizës së kryer nga Komisioni, nuk e konsideroi të nevojshëm analizimin e pikave të tjera të

rezultateve të hetimit (cituar në poshtëshënimin nr. 53 të vendimit të Komisionit), pasi problematikat e rezultuara lidhur me deklaratimet e pasurive, mjaftojnë për aplikimin e masës disiplinore, duke mos e trajtuar më tej konfliktin e interesit për të cilin Komisioni i ka kaluar barrë prove subjektit të rivlerësimit. Pra, Komisioni në vendim nuk ka mbajtur qëndrim për këtë situatë dhe, për rrjedhojë, ajo nuk përbën një nga shkaqet mbi të cilat ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë. Për rrjedhojë, edhe subjekti i rivlerësimit, referuar këtij konkluzioni të Komisionit, nuk ka ngritur pretendime në ankimin e paraqitur prej tij lidhur me konfliktin e interesit. Si rrjedhojë e sa më sipër, çështjen e të ardhurave për të cilat Komisioni ka kaluar barrën e provës sepse subjekti i rivlerësimit duket se ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, trupi gjykues vlerësoi të mos ia nënshtrojë shqyrtimit në Kolegj.

14.9 Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me gjetjet e konstatuara, sipas të cilave: *Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, lidhjen e kontratës paraprake me shoqërinë “{***}” ShPK; ka një diferencë të pajustificuar ndërmjet çmimeve të apartamenteve të porositura në vitin 2011 dhe të blera në vitin 2014; për kryerjen e pagesës së këstit të parë në vitin 2011, duket se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 7.512.680 lekë; për pagesën e këstit të dytë në vitin 2014, subjekti duket se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 1.042.660 lekë.*

14.10 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti dorëzoi në seancë dëgjimore parashtrimet në të cilat, lidhur me barrën e provës së kaluar nga Komisioni, është përgjigjur se pagesën në shumën 59.000 euro, nuk e kujton, pasi kontrata është anuluar në vitin 2011, por pagesa është kryer nga shuma e përfituar nga dhurimi i babait të tij, në shumën prej 9.300.000 lekësh. Sipas shpjegimeve të tij, kjo shumë i është dhënë subjektit nga babai më herët, ndonëse deklarata noteriale është bërë në dhjetor të vitit 2012, e cila ka pasur për qëllim vetëm dokumentimin e dhurimit.

Subjekti shpjegon se nuk ka deklaruar gjendje *cash*, si pasojë e pagesës së kryer për këtë pasuri, duke shpjeguar se nëse do ta kishte përfituar në dhjetor të vitit 2012 dhurimin, nuk do kishte pasur mundësi ta shpenzonte atë shumë. Pjesën tjetër të këstit shpjegon se e ka paguar në vitin 2014. Sipas tij, për pagesën e kryer në vitin 2014, kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e tokës së bashkëshortes në vitin 2013, në shumën 6.000.000 lekë, dhe të ardhurat e mbetura nga dhurimi i kryer nga babai, prej 9.300.000 lekësh. Gjithashtu, subjekti ka argumentuar se me deklarin e të ardhurave ndër vite, ka vlerësuar se në këtë mënyrë ka deklaruar edhe faktin që një pjesë ose totalin e tyre e ka pasur gjendje *cash* në fund të vitit. Subjekti ka shpjeguar se lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të babait të tij, që kanë mundësuar dhurimin e shumës prej 9.300.000 lekësh, është provuar me vendimin e pushimit të hetimit në procedimin penal ndaj tij, nga prokuroria dhe gjykata.

14.11 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012, dhurimin e shumës prej 9.300.000 lekësh nga babai i tij, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 31.12.2012. Gjithashtu, në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si dhuratë nga babai i tij, edhe shumën prej 400.000 lekësh, me burim nga dëmshpërblimi i përfituar nga babai. Lidhur me dhurimin e shumës prej 9.300.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si të dhuruar nga babai, ky i fundit ka argumentuar se konkluzioni i Komisionit për mosprovueshmërinë

e marrëdhënies së qirasë që ka pasur babai i tij me tokën, është i gabuar, pasi me vendimin penal, provohet tërësisht marrëdhënia e qirasë që ka pasur babai i tij me blegtorët, nga e cila ka përfituar të ardhura të ligjshme. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se vendimi gjyqësor për pushimin e çështjes penale, në bazë të nenit 253 të K.Pr.Civile, si akt zyrtar është provë e plotë për faktet që përmban në të. Në dosjen e ILDKPKI-së, gjendet e administruar deklarata noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 31.12.2012, sipas së cilës babai i subjektit H. K. deklaroi se pas vdekjes së bashkëshortes së tij, më datë 09.12.2012, është bashkuar me familjen e të birit Tomorr Kullolli dhe në këtë moment, i ka dorëzuar subjektit të rivlerësimit shumën prej 9.300.000 lekësh, të cilat i ka kursyer gjatë gjithë jetës së tij. Lidhur me pretendimin e subjektit se me pushimin e procedimit penal nga prokuroria dhe gjykata (paragrafi 14 më sipër), është provuar burimi i ligjshëm i shumës prej 9.300.000 lekësh, të dhuruara nga babai, Kolegji sjell në vëmendje se në rastin e pushimit të procedimit penal sipas nenit 328, pika 1, shkronja “a” e K.Pr.Penale, ligji ka parasysh se fakti nuk ekziston, që do të thotë se nuk ka vepër penale. Veprimet e personit vërtet mund të jenë të kundërligjshme, por ato nuk janë të dënueshme penalisht e të parashikuara nga dispozitat e Kodit Penal. Si rrjedhojë e sa më sipër, fakti se procedimi penal është pushuar nga gjykata, nuk përlligj të ardhurat e babait të dhuruara subjektit të rivlerësimit, legjitimimi i të cilave duhet të plotësojë standardet e vendosura nga Kolegji, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

14.12 Lidhur me këtë deklaratë noteriale, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, ka ftuar subjektin e rivlerësimit të paraqesë dokumentacion ligjor që vërteton burimin e ligjshëm të krijimit të shumës, në total prej 9.300.000 lekësh, nga babai, që ka mundësuar më pas dhurimin. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se për këtë deklaratë, është kallëzuar nga ILDKPI-ja në prokurori dhe ka dhënë shpjegime në prokurori dhe gjykatë, duke vënë në dispozicion vendimin¹³ e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 26.10.2015 dhe vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {***}¹⁴, datë 11.02.2016.

14.13 Kolegji vëren se lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave të z. H. K., si person tjetër i lidhur, për shkak të marrëdhënies së dhurimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2012, ka detyrimin, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të cilat kanë mundësuar dhurimin e shumës 9.300.000 lekë subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me këtë shumë, të pretenduar nga subjekti si të

¹³ILDKPKI-ja, me cilësinë e kallëzuesit, më datë 28.04.2015, ka depozituar kallëzimin penal për subjektin e rivlerësimit, ku pjesë e objektit, ndër të tjera, ka qenë dhurata e babait e deklaruar në vitin 2012, në vlerën 9.300.000 lekë, me burime jo të ligjshme financiare, pasi ky i fundit ka qenë pensionist dhe nuk ka pasur mundësi kursimi të kësaj shume. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 328, germa “b” e K.Pr.Penale, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***}.

¹⁴ Kundër këtij vendimi, ka ngritur ankim subjekti i rivlerësimit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të pushimit për formulim më të favorshëm, konkretisht nga baza ligjore, neni 328, germa “b” e K.Pr.Penale, të vendoset neni 328, germa “a” e këtij Kodi, pasi vetë organi i prokurorisë ka konstatuar se fakti nuk ekziston, ndaj duhej të pushohej çështja sipas germës “a” të nenit 328 të K.Pr.Penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës së ankuesit Tomorr Kullolli, ndryshimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***}, datë 26.10.2015, sipas nenit 328, germa “a” e K.Pr.Penale, vendim i cili nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë më datë 21.02.2016.

dhuruar nga babai i tij, rezulton se në dosje janë administruar disa dokumente nga institucionet shtetërore në lidhje me të ardhurat e familjes së babait të subjektit të rivlerësimit. Nga kontrolli i analizës së Komisionit, për mundësinë e kursimit të kësaj shume nga babai i subjektit, Kolegji i konsideroi si të drejta për t'u përlllogaritur të ardhurat sipas dokumenteve në dispozicion, të administruara në dosjen e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në pyetësorin nr. 2 të Komisionit se babai i tij i ka përfituar të ardhura që i kanë mundësuar kursimin e shumave të dhuruara atij, edhe nga dhënia me qira e tokës që zotëronte *de facto* që nga viti 1991, e cila më pas u është njohur dhe kthyer me vendim gjykate në vitin 2016. Përfitimi i të ardhurave nga qiradhënia e tokave, sipas pretendimit të subjektit, nuk u provua me dokumentacion ligjor, pasi në kohën kur subjekti pretendon se babai i tij i ka dhënë me qira për kullotë, nuk legjitimohej për disponimin lirisht të këtyre tokave. Gjithashtu, nuk u provua nga subjekti të jetë lidhur ndonjë kontratë qiraje për shfrytëzimin e tokës, çka përjashton edhe mundësinë që të jenë paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura. Për më tepër, të ardhurat e pretenduara nga qiradhënia i përkasin një kohe kur babait të subjektit nuk i ishte njohur nga organet përkatëse, kthimi i tokës, për pasojë, nuk ka qenë pronar i ligjshëm i pasurisë së dhënë me qira. Nga kontrolli që i bëri analizës së Komisionit, Kolegji i rezultoi se të ardhurat e dokumentuara të familjes së babait të subjektit të rivlerësimit, kanë qenë në shumën 6.923.439 lekë. Në këtë shumë janë përfshirë të ardhurat nga pensionet dhe të ardhurat nga dëmshpërblimet si i përndjekur politik. Nga sa më sipër, rezulton se të ardhurat në shumën 6.923.439 lekë, pa zbritur këtu shpenzimet e jetesës së familjes së babait, nuk janë të mjaftueshme për të krijuar një kursim në shumën 9.300.000 lekë, për të cilën subjekti ka pretenduar se ia ka dhuruar babai, si rrjedhojë Kolegji e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit që kjo shumë të mos përfshihet në analizën financiare të subjektit dhe as si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi.

14.14 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se nga shitja e tokës në pronësi të bashkëshortes në fshatin Levan, Fier, ka fituar të ardhura në masën 6.000.000 lekë, ligjshmëria e të cilave njihet nga Komisioni. Subjekti argumenton se nuk njihet ekzistenca e tyre në vitin 2014, për shkak të mosdeklarimit *cash* në banesë në fund të vitit 2013. Subjekti pretendon se është i vërtetë ky fakt, ashtu si edhe për disa vite të mëparshme, që nuk ka deklaruar gjendjen *cash*, megjithëse ka pasur gjendje të tillë. Sipas subjektit të rivlerësimit, me anë të deklarimit të të ardhurave, ai njëkohësisht ka vlerësuar se ka deklaruar edhe një pjesë të tyre ose të gjithë gjendjes në fund të vitit. Sipas subjektit të rivlerësimit, me çmimin e shitjes së tokës mbulohet tërësisht pjesa e pambuluar prej 1.042.660 lekësh. Subjekti argumentoi se nga analiza e kryer në Komision, ai rezulton me gjendje pozitive mbi 5.100.000 lekë në vitin 2013, shumë e cila provon faktin se ka pasur gjendje *cash* në banesë në vitin 2014. Në këto rrethana, subjekti pretendon se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti.

14.15 Kolegji vëren se lidhur me të ardhurat nga shitja e tokës në pronësi të bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2013, se është shitur toka në datën 10.09.2013, ndodhur në Levan, Fier, përfituar nga bashkëshortja e tij sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, shitur në vlerën 6.000.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar se ku janë depozituar të ardhurat nga shitja e tokës në vitin 2013. Analiza financiare e vitit 2013 rezulton me një diferencë

të lartë pozitive (5.191.438 lekë), duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar kursime në fund të vitit. Në deklaratën e pasurisë për vitin 2014, subjekti deklaroi blerjen e apartamentit, por nuk deklaroi burimin që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, nuk rezultoi asnjë gjurmë e kalimit të shumës 6.000.000 lekë, të pretenduar si të përfituar nga shitja e tokës nga blerësi të bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Në udhëzimin nr. 6915/2, datë 30.01.2012, “Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit”, në pikën 4 të tij parashikohet: *Me realizimin e kontratës, pala blerëse duhet të derdhë çmimin e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në llogarinë bankare të noterit. Për këtë qëllim, blerësi pajiset nga noteri me të dhënat e sakta në lidhje me emërtimin dhe numrin e llogarisë bankare. Vetëm pas paraqitjes së dokumentit bankar që vërteton se çmimi i tjetërsimit është derdhur në llogarinë e noterit, kontrata firmoset nga të dyja palët.* Në pikën 7 të këtij udhëzimi, parashikohet: *Me marrjen në dorëzim të certifikatës së pronësisë, brenda 24 orëve, noteri transferon në llogarinë bankare të shitësit shumën e depozituar nga blerësi në llogarinë bankare të tij [...].* Sipas këtij parashikimi, transaksioni i shitjes së pasurisë truell në pronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, duhej të kanalizohet nëpërmjet llogarive bankare, fillimisht të noterit që ka realizuar kontratën e shitjes së truellit, e më pas të bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit si shitëse e pasurisë së paluajtshme. Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk provoi se shuma e përfituar nga shitja e tokës, ka ekzistuar në llogari bankare, dhe nëse është tërhequr nga llogaria bankare për të mbështetur pretendimin e tij se në vitin 2013 ka pasur gjendje *cash* në banesë, të derivuar nga shitja e pasurisë truell në pronësi të bashkëshortes së tij.

14.16 Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për moskonsiderimin e kursimeve *cash* në banesë, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit me burim nga shitja e tokës së bashkëshortes në Levan, sipas qëndrimit të mbajtur në paragrafin 12.6 më sipër për kursimet *cash*, duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar se çfarë pjese e të ardhurave nga shitja e tokës janë kursyer, dhe nga ana tjetër këto të ardhura nuk janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 se kanë shërbyer si burim në blerjen e apartamentit në Tiranë. Në deklaratën *vetting*, për këtë pasuri është deklaruar si burim “të ardhurat familjare”, pa specifikuar nga shitja, dhurimi apo pagat, duke pamundësuar në këtë mënyrë kontrollin për të identifikuar me saktësi se cili burim është kursyer.

14.17 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, në rubrikën e pasurive, tokë ullishtë me sip. prej 10 hektarësh në komunën Fierzë, Elbasan (tokë të babait për të cilën subjekti ishte në pritje t’i kthehet, pasi ishte e lirë), të cilën e ka marrë me qira dhe pret subvencion nga shteti. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga ullishta në DIPP-të e viteve 2014, 2015, 2016 dhe 2017. Subjekti u pyet nga Komisioni duke e ftuar të vendosë në dispozicion dokumentacionin e fitimit të pronësisë, dokumentacionin që vërteton shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet e mbjelljes së ullishtës, procedurat e aplikimit dhe të përfitimit për subvencionim nga shteti, numrin e llogarisë në të cilën është disbursuar subvencioni, si dhe institucionin nga ku janë përfituar këto të ardhura. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se tokën ullishtë e kanë pasur në pronësi familja e tij derisa ia mori reforma agrare. Pas vitit 1991, babai e ka shfrytëzuar këtë sipërfaqe toke të pandarë, duke ua dhënë me qira fshatarëve për kullotë për bagëtitë. Pas vitit

2010, një pjesë të kësaj sipërfaqeje toke, është mbjellë me ullinj dhe me vendimin nr. {***}, datë 04.03.2016, sipërfaqja e lirë i është kthyer, ndërsa pjesa tjetër është njohur për t'u kompensuar. Subjekti shpjegon se nuk ka paguar qira pasi ishte toka e tij, po ashtu ka kërkuar subvencionim nga shteti dhe nuk i është miratuar. Subjekti ka shpjeguar gjithashtu se ka deklaruar në ILDKPKI të ardhura nga toka për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017, por për këto të ardhura nuk disponon dokumentacion (përfitimi i këtyre të ardhurave është bërë pa dokumente, shitja e vajit të ullirit dhe prodhime të tjera janë bërë privatisht, në treg të lirë). Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion shpenzimet e kryera për tokën, si: pagesa e qirasë dhe e mbjelljes së ullishtës, që i janë kërkuar nga Komisioni t'i vihen në dispozicion, por nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se ka paraqitur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 04.03.2016, i cili është lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. {***}, datë 25.11.2016, ku, ndër të tjerë, njihet si pronar Tomorr Kullolli, si trashëgimtar i D. K.. Si rrjedhojë e këtij dokumentacioni, provohet se toka është përfituar ligjërisht në vitin 2016 dhe subjekti ka filluar ta shfrytëzojë atë që nga viti 2011, duke e shfrytëzuar pa leje dhe pa e pasur në pronësi tokën, në kushtet e posedimit të paligjshëm, për rrjedhojë të ardhurat që subjekti ka pretenduar se i ka gjeneruar nga toka ullishtë, Kolegji i vlerësoi të paligjshme dhe pa efekte në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të sa më sipër, lidhur me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si të krijuara nga ullishta në vitet 2014, 2015 dhe 2016, Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos i përfshirë në analizën e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, për arsye se nuk është administruar asnjë dokumentacion për përfitimin e tyre, duke mbetur në nivel deklarativ për sa subjekti ka pretenduar.

14.18 Sa më sipër analizuar lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 134 m², blerë nga subjekti i rivlerësimit në Tiranë, rezultoi se subjekti nuk provoi burimin e krijimit të kësaj pasurie, për arsye se për të ardhurat prej 6.000.000 lekësh, të përfituara nga shitja e pasurisë së bashkëshortes në vitin 2013, nuk gjenden gjurmë të lëvizjes së gjendjes së *cash-it*, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka specifikuar nëse i ka shpenzuar apo kursyer në një formë të caktuar. Në këto kushte, Kolegji vlerësoi të mos merren në konsideratë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, si burim i krijimit të kësaj pasurie. Sa i përket shumës prej 9.300.000 lekësh, të dhuruar nga babai, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor dhurimin e kësaj shume, si dhe në kuadër të detyrimit që rrjedh nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk u provua mundësia e krijimit të saj nga babai i subjektit me burime financiare të ligjshme, duke mos e përfshirë as këtë shumë si burim krijimi të pasurisë. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit nuk provoi se ka krijuar të ardhura nga ullishta, sipas deklarimeve në DIPP-të përkatëse, si dhe se këto të ardhura janë krijuar që në vitin 2011, para se të bëhej pronar me vendimin e gjykatës së datës 04.03.2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi që këto të ardhura të mos konsiderohen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të analizës së këtij shkaku ankimi, nga kontrolli që Kolegji i bëri analizës së Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kishin mundësi të kryenin investimin me burime financiare të ligjshme në vitin 2011, për pagesën e kështit të parë prej 59.000 eurosh, për blerjen e apartamentit me sip. 134 m² në Tiranë, për diferencën negative në shumën -7.512.680 lekë, si dhe pagesën e kështit të dytë

prej 10.371 eurosh deri në prill të vitit 2014, për diferencën negative në shumën -1.042.660 lekë, duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

15. **Lidhur me rezultatet e analizës financiare**, subjekti i rivlerësimit ka ankuar çështjet si në vijim.
- (i) Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se marrëdhënia e huasë është private dhe Kodi Civil nuk përcakton se ajo duhet të bëhet me shkrim. Subjekti pretendon se ka paraqitur deklarata noteriale që provojnë marrëdhëniet e huave, ndaj provohet tërësisht marrja e tyre në vitin 2006 dhe kthimi tyre siç i ka deklaruar në DIPP-të përkatëse. Gjithashtu subjekti pretendon se i janë llogaritur si shpenzime nga viti 2007 e në vijim, shumat e kthyera nga huamarrja, ndërkohë nga Komisioni nuk është pranuar marrja e huave. Subjekti sqaron se nëse nuk pranohet marrja e huave, nuk duhet të llogariten si shpenzime në vitet e mëpasshme shumat e kthyera, pasi dyshim për fiktivitetin e kontratave do krijohej nëse subjekti nuk do t'i kishte kthyer huatë, të paktën deri në vitin 2016, duke sqaruar se për kthimin e huave kanë shërbyer të ardhurat nga pagat, nga aksionet dhe të ardhurat nga qiraja prej 600.000 lekësh çdo vit, të cilat kanë qenë të mjaftueshme.
 - (ii) Sipas subjektit të rivlerësimit, apartamenti me sip. 67,4 m² i blerë në vitin 2004, është përshtatur për objekt tregtie dhe është dhënë me qira, të ardhura për të cilat pretendon se i ka deklaruar në deklaratat periodike të pasurisë për të provuar marrëdhënien e qirasë. Subjekti i rivlerësimit sqaron se e ka paguar tatimin në burim për të ardhurat nga qiraja, por nuk disponon dokumentacion, si rrjedhojë pretendon që këto të ardhura t'i konsiderohen si burim i ligjshëm.
 - (iii) Lidhur me shpenzimet e shkollimit të djalit, subjekti pretendon se të dhënat e akteve të dorëzuara prej tij dhe ato të përdorura si prova nga Komisioni janë akte me të njëjtin burim e, për këtë shkak, kanë të njëjtën fuqi provuese. Sa i përket përfitimit apo kalimit të bursave, ato nuk përfitohen nga studenti në llogarinë e tij apo *cash*, por nga shuma totale e shpenzimeve të shkollimit, zbritet ajo që përfitohet si bursë dhe bëhet pagesa e diferencës. Në lidhje me diferencën negative pas përfshirjes së bursës në shpenzimet e shkollimit, subjekti parashtron në ankim se Komisioni në vendim nuk e analizon këtë pikë dhe, për këtë arsye, subjekti është në pamundësi të argumentojë të kundërtën, por pretendon se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet.

15.1 Konkluzionet e Komisionit për analizën financiare: [...] *Vlen të theksohet se edhe nëse do të pranoheshin pretendimet e subjektit dhe do të përfshiheshin në analizë financiare shumat e përfituara nga djali i tij në formën e bursave të studimit dhe, veç tyre, të mos konsideroheshin si shpenzime të subjektit as shumat e deklaruara prej tij si pagesa, ndër vite, për kthimin pas të huave (sipas tij, meqenëse ato nuk janë konsideruar nga Komisioni si burime të ligjshme), rezultati i përgjithshëm i analizës financiare do të ndryshonte nga -37.554.251 lekë në -31.382.662 lekë, duke mos ndryshuar kështoj as konkluzioni final lidhur me kriterin e pasurisë dhe as pasqyellja e pasojave përkatëse të këtij konkluzioni mbi rivlerësimin e subjektit.*

Në vijim, Komisioni konkludon në vendim për analizën financiare:

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se për sa i takon kriterit të pasurisë, bazuar në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, subjekti i rivlerësimit, z. Tomorr Kullolli, nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet e konstatuara dhe, njëkohësisht, për të

përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Nisur nga ky rezultat financiar, trupi gjykues nuk e konsideron të nevojshëm analizimin¹⁵ e pikave të tjera të rezultateve të hetimit, pasi referuar problematikave që kanë rezultuar lidhur me deklaratimet e pasurive të sipërtrajtuara, mjaftojnë për aplikimin e masës disiplinore.

15.2 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se huamarrjet jo detyrimisht duhet të finalizohen me kontrata, trupi gjykues vlerëson se Komisioni nuk i ka kaluar subjektit barrën e provës për ngritjen e dyshimeve mbi fiktivitetin e këtyre huave, për sa kohë subjekti i ka deklaruar si burime dhe si shpenzime në fazën e shlyerjes së tyre ndër vite, por i ka kaluar barrën e provës në mënyrë që të provojë burimin e ligjshëm të shumave të përfituara nga subjekti nëpërmjet këtyre huave. Kolegji vlerëson se gjendet i drejtë qëndrimi i Komisionit për moskonsiderimin si të ligjshme të përfitimeve nga huatë dhe verifikimin e mundësive financiare për kthimin pas të tyre përgjatë viteve dhe në masat e deklaruara nga subjekti. Gjithsesi, Kolegji vlerësoi se edhe sikur të mos përfshiheshin shlyerjet e huave në vitet 2007, 2009, 2010 dhe 2011, do të përmirësohej vetëm situata e viteve 2007 dhe 2009, por sërish bilanci i përgjithshëm negativ i analizës financiare për periudhën 2003-2016, do të mbetej në nivel të lartë. Si rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se dështimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve, nuk passjell shuarjen e efekteve financiare të shlyerjes së huave, pasi ato janë deklaruar si shpenzime të kryera në deklaratat periodike në vitet përkatëse.

15.3 Lidhur me të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e apartamentit me sip. 67,4 m², i përshtatur për njësi shërbimi, Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se nga DIPP-ja e vitit 2008, subjekti ka deklaruar çdo vit të ardhura nga dhënia me qira e këtij apartamenti të ndodhur në Elbasan, duke deklaruar si të ardhura nga dhënia me qira, shumën 600.000 lekë në vit, përveç vitit 2016, për të cilin janë deklaruar të ardhura në shumën 500.000 lekë. Ndërkohë, në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura në total në shumën 4.800.000 lekë nga qiradhënia e këtij apartamenti. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vetëm tri kontrata qiraje, përkatësisht: (i) kontratën nr. {***} kol. (pa nr. rep.), të lidhur në datën 17.10.2011, ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe qiramarrësit A. R., për një afat njëvjeçar, nga data 01.11.2011 deri 01.11.2012, kundrejt qirasë 15.000 lekë në muaj, për një dhomë në apartamentin me sip. 67,4 m²; (ii) kontratën nr. {***} prot., datë 25.11.2013, ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe qiramarrëses H. P., për një afat 5-vjeçar, kundrejt qirasë 15.000 lekë në muaj, për një ambient me sip. 25 m² të pasurisë në fjalë; (iii) kontratën nr. {***} regj., datë 13.01.2009, të lidhur ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe qiramarrësit K. B., për një afat 1-vjeçar, kundrejt qirasë 20.000 lekë në muaj. Nga përmbajtja e kontratave të qirasë të paraqitura nga subjekti, për aq sa është administruar në dosjen e Komisionit, nga përlllogaritja rezultojnë të ardhura në shumën totale prej 1.320.000 lekësh.

15.4 Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me dokumentacionin ligjor që vërteton ndryshimin e destinacionit të pasurisë në fjalë nga apartament në njësi shërbimi, për mospërputhjet e konstatuara lidhur me të ardhurat e qirasë, deklaruar në

¹⁵ Lidhur me automjetin, tokat dhe konfliktin e interesit.

deklaratat periodike dhe kontratat e qirave të paraqitura, si dhe nëse janë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e gjeneruara nga dhënia me qira e apartamentit. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Kam deklaruar dhe në deklarata periodike, ky apartament është kthyer në tri njësi shërbimi dhe është dhënë me qira ndër vite me kontrata deri në një vit. Në shumicën e rasteve nuk janë lidhur kontrata me shkrim, disa kontrata kanë qenë të lidhura ndërmjet palëve, të cilat nuk janë ruajtur, por dhe kontrata të nënshkruara te noteri, disa prej të cilave janë pasqyruar të bashkëlidhura me deklaratat periodike, kur janë kërkuar.*

Dokumentacioni ligjor që vërteton ndryshimin e destinacionit të pasurisë në fjalë nga apartament në njësi shërbimi, nuk është regjistruar. Lidhur me shpenzimet, nuk është bërë ndonjë shpenzim i mirëfilltë dhe se vlera e tyre nuk e kalon shumën e kërkuar për deklarim sipas ligjit në vitin përkatës, pasi vetë pozicioni i apartamentit ishte i tillë, i kishte dritaret e dhomave në vijë të drejtë, të cilat u kthyen nga dritare në dyer për secilën njësi shërbimi. Detyrimet tatimore sa u përket të ardhurave të përfituara ndër vite nga qiraja, sqarohet se janë paguar disa vite.

15.5 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës pasi ka konstatuar se të gjitha shumatat e pretenduara si të përfituara nga qiradhënia e apartamentit, në analizën e periudhës 2008 – 2016, nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë për to nuk janë paguar detyrimet tatimore. Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultojnë se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, me shkresat nr. {***} prot., datë 07.02.2020, dhe nr. {***} prot., datë 10.02.2020, kanë konfirmuar se subjekti i rivlerësimit figuron i regjistruar si individ privat në datën 30.04.2018, momenti kur rezultojnë të ketë dorëzuar Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA) të vitit 2017 dhe nuk ka rezultuar ndonjë pagesë për tatimin mbi të ardhurat nga qiradhënia. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, në mbështetje të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme do të konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Në përfundim të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, përveç faktit se kishte mospërputhje të të ardhurave të deklaruara në deklaratimet periodike me dokumentacionin e dorëzuar prej tij, duke mos provuar të ardhurën e pretenduar të përfitur nga qiraja, nuk provoi as se për këto të ardhura të krijuara nga qiraja, ka paguar detyrimet tatimore. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi të drejtë qëndrimin e Komisionit që të ardhurat e pretenduara të krijuara nga qiraja, të mos konsiderohen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

15.6 Lidhur me shpenzimet e shkollimit të djalit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni konkludoi se: “Lidhur me provat e paraqitura përgjatë seancës së datës 07.06.2021, nuk i konsideron në formën dhe përmbajtjen e duhur për t’i vlerësuar me vlerë të plotë provuese, për sa kohë ato nuk vërtetojnë kalimin/përfitimin konkret të shumave të referuara si bursa studimi. Megjithatë, duke konsideruar rrethanat specifike dhe impaktin e tyre, konstaton se edhe duke i përfshirë ato si të ardhura në analizën financiare, pra, duke pakësuar shpenzimet e përballuara nga subjekti për arsimimin e fëmijëve, rezultati do të përmirësohet me vlerën prej 3.064.344 lekësh, por pamundësia për t’i përballuar të gjitha shpenzimet e arsimimit në fjalë, vijon të mbetet e konsiderueshme.

15.7 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet e arsimit të fëmijëve të tij nga viti 2012 e në vijim, përkatësisht: në shumën 4.713 euro në 2012; në shumën 4.600 euro në 2013; në shumën 6.600 euro në 2014; në shumën 19.250 euro në 2015; si dhe në shumën 25.000 euro në vitin 2016, fillimisht pranë institutit arsimor “{***}” dhe më pas studimet e larta në Francë dhe në Itali.

Me kërkesën¹⁶ e Komisionit, institucioni arsimor “{***}” ka dërguar informacionin¹⁷ për pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit për fëmijët D. K. për periudhën 2012-2015 dhe U. K., për periudhën 2012-2018.

15.8 Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 4, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit informacion mbi arsimin e ndjekur nga fëmijët e tij jashtë Shqipërisë, duke i kërkuar të dorëzojë edhe dokumentacionin që të provojë shpenzimet e kryera për secilin prej tyre. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Si në deklaratën vetting, ashtu dhe në deklaratat periodike kam pasqyruar vit pas viti si shkollën e djalit, ashtu edhe të vajzës. Djali ka filluar studimet e larta në vitin shkollor 2015 - 2016 në Universitetin {***}. Në vitin 2016-2017, në kuadër të këtyre studimeve, ka vazhduar një vit tek Universiteti “{***}” në Milano, Itali. Ka përfunduar studimet në Universitetin {***}, në vitin shkollor 2018-2019. Vajza ka filluar studimet e larta në vitin shkollor 2018-2019 e në vazhdim në Universitetin {***}. Sqaroj se të gjitha shpenzimet, si për shkollë, dhe shpenzime jetese, janë pasqyruar në vitet përkatëse në deklarin periodik të pasurisë (shpenzimet janë pasqyruar si shpenzime të kryera brenda vitit kalendarik, jo vitit shkollor). Lidhur me dokumentacionin që provon shpenzimet e kryera për shkollimin e fëmijëve jashtë shtetit, ju bëj me dije se këtë dokumentacion e kam dërguar të plotë bashkëlidhur përgjigjeve të mëparshme dërguar KPK-së, po kështu e kam bashkëlidhur në deklarinet periodike.*

15.9 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit i ka vënë në dispozicionin Komisionit lëvizjet bankare të bashkëshortes së tij, në të cilat evidentohen pagesat në formën e transfertës që janë bërë për pagesën e shkollimit të fëmijëve. Komisioni ka kryer një kërkim në faqet *online* të universiteteve, për t’u informuar rreth tarifave të shkollimit dhe shpenzimeve të tjera gjatë qëndrimit në universitet për djalin e subjektit të rivlerësimit dhe ka rezultuar se për vitin 2015, shpenzimet e arsimimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme gjatë vitit, për një student, kanë qenë në shumën 22.998 euro, ndërsa për vitin 2016 kanë qenë në shumën 35.962 euro. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se djali i tij ka përfituar bursë nga shkolla në shumën 11.000 euro për vitin 2015, ndërsa për vitin 2016 ka përfituar bursë në shumën 11.460 euro.

15.10 Subjekti i rivlerësimit, bashkë me parashttrimet, paraqiti në Komision komunikime elektronike të djalit të tij me Universitetin {***}. Sipas këtij dokumentacioni, për vitin akademik 2015-2016, shkollimi ka kushtuar 27.220 euro, përfshirë bursën, sigurimi shëndetësor ka kushtuar 845 euro, tarifa e orientimit 420 euro. Nga këto shpenzime zbritet vlera e bursës 11.000 euro dhe totali i detyrimit të shkollimit të djalit të subjektit të rivlerësimit për vitin akademik 2015-2016, ka qenë në shumën 17.845 euro. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për vitin 2015, shpenzimet e

¹⁶ Shkresa nr. {***} prot., datë 10.11.2020.

¹⁷ Shkresa nr. {***} prot., datë 24.11.2020.

shkollimit të djalit në shumën 14.500 euro, ndërsa vlera e bursës sipas dokumentacionit, ka qenë në shumën 11.000 euro.

Për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet e shkollimit të djalit në shumën 22.000 euro, ku vlera e bursës sipas dokumentacionit ka qenë në shumën 11.460 euro. Totali i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si tarifë shkollimi për vitin 2016, duke përfshirë edhe bursën, rezulton të jetë në shumën 33.460 euro, ndërsa përlllogaritja e kryer nga Komisioni si shpenzim shkollimi për vitin 2016, ka rezultuar në shumën 35.692 euro.

15.11 Kolegji vëren se nga dokumenti i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me tarifat e shkollimit, rezulton se ato janë të detajuara për zërat e shkollimit dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme në një vit akademik, ku shpenzimet e shkollimit për periudhën 2015-2016 dhe 2016-2017, në total kanë qenë në shumën 55.580 euro, ndërsa sipas përlllogaritjes së Komisionit, shpenzimi për shkollim rezulton në vlerën 58.690 euro. Duke qenë se dokumenti i paraqitur në Komision nga subjekti i rivlerësimit, është me të dhëna të plota për shpenzimet, Kolegji vlerësoi t'i konsiderohen të dhënat e këtij dokumentacioni që ka paraqitur subjekti, për t'iu referuar shumës totale të shpenzimeve të shkollimit, por duke konsideruar si të përfituar bursën nga universiteti, si një e ardhur e cila është përdorur për të mbuluar shpenzimet e shkollimit.

15.12 Në përfundim të analizës së këtij shkaku ankimi, nga kontrolli që Kolegji i bëri analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues vlerësoi se, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, ka rezultuar se gjatë viteve 2015 dhe 2016, subjekti i rivlerësimit, edhe duke i zbritur vlerën e bursave të përfituara sipas dokumentacionit të paraqitur prej tij, nuk ka pasur mundësi të përballojë shpenzimet e shkollimit të djalit në vitet 2015 dhe 2016, përkatësisht për diferencat negative -3.882.508 lekë dhe -1.674.591 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

15.13 Nga sa më sipër, në kontroll të analizës financiare të Komisionit për periudhën 2003-2016, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij rezultojnë me diferencë negative në shumën totale prej -33.984.300 lekësh. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit për këtë periudhë nuk ka justifikuar me burime financiare të ligjshme krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

16. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nga Komisioni, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Tomorr Kullolli gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 396, datë 09.06.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 396, datë 09.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Tomorr Kullolli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 25.10.2023.

ANËTAR

Sokol Çomo

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha Mulaj

nënshkrimi

ANËTARE

Ina Rama

nënshkrimi

RELATORE

Albana Shtylla

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta Schuetz

nënshkrimi